



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primenë Më/Dana: 19-11-2019			
Nr./ organit Org.broj	Numri/Broj	Shënimi Prilog	Vlera Vrednos
01-060/01-1164			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 Qershor, 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL), Nr 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

FTESË

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -X-, të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datë: **26.11.2019, (e Martë)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në **Biblotekën** në Shtëpinë e Kulturës, "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

Rendite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Kuvendit Komunal të Vitisë.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullorë për palestrën sportive
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të Draft Strategjisë Komunale kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2019-2023
4. Informata mbi përgatiten e të mbjellave vjeshtore

Viti, më 19.11.2019

Kryesuesi i Kuvendit
Naim Pira





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË NËNTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 30.10.2019, (e Mërkurë), në Bibloteken në Shtëpinë e Kulturës "Gursel dhe Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 10h. mbledhje morën pjesë: Nënkryetari z.Hasan Aliu, kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emmini, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri, ndërsa mungoj Remzi Salihu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e nëntë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Me lejoni të ju përshëndesë të gjithë të pranishmit, në mbledhjen e fundit të KPF-së me kane kërkuar disa informacione rreth shpenzimeve që i ka bërë kuvendi Komunal unë ju kam përgatitur informatën dhe tani po ju dorëzoj, tani kalojmë te pyetjet jashtë rendit të ditës.

znj. Mirlinda Sadiku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kame pyetje për ekzekutivin, për drejtorin e Urbanizmit, nëse nuk gaboj në seancën e muajit Mars 2018 është aprovu, ju ka dhënë leje nga Kuvendi Komunal i Vitisë që të fillohet me planin zhvillimor komunal, aty sipas vendimit është 18 muaj nga ajo datë. Me sa e di unë me 4 korrik 2019 keni marrë një punëtor lidhur me këtë plan, me intereson ta di drejtor ku ka arrit ky proces. Është pyetje edhe për kryesuesin, mungesa e drejtoreshës së Arsimit, sepse nuk ka pas informatë lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2018-2019 dhe fillimin e ri shkollor 2019-2020, që ma merr mendja ka qenë shumë me rëndësi me pas këtë informatë si dhe po ashtu këtu e kam një kontratë e cila ka të bëjë me shfrytëzimin e sallës së edukimit fizik, kontratë kjo e lidhur në mes të Drejtorisë së Kulturës, Sport; Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Shkollës së Mesme Profesionale "Januz Zejnullahu", Është fakt, është e evidente që salla është demtu kjo shumë si dhe në nenin 6 të kësaj kontrate thuhet, se klubet sportive që ushtrojnë në sallë për çdo dëmtim gjatë kohës së shfrytëzimit janë të obliguar t'i riparojnë dëmet e shkaktuara brenda një dite. Ekzistojnë dëme të evidentuara, të cilat janë të shumta dhe po ashtu që 6 herë i ndërrohet qelësi atij institucioni. D.m.th me një fjalë ky institucion ka mbetur si pa zot shpije. Përgjegjësia po mbetet askund, kur ja shtojmë kësaj që aty mbahet mësim, e ushtrojnë klubet e Vitisë, papastërtia është jashtëzakonisht e madhe. Kërkoj nga institucioni përkatës, d.m.th DKA-ja që të marrë me kontratë mbi vepër, pasi që lejohet të ketë një përkujdesje me të madhe nga punëtorët teknik dhe këto dëme asnjëherë nuk janë rregullu e as kompenzuar nga klubet të cilët kanë ushtruar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që ishte një pyetje e adresuar për mu, unë po tu përgjigjem. Unë gjate përpilimit të rendit të ditës, këtë e bej si zakonisht, propozimet vinë nga ekzekutivi, unë e përpiloj rendin e ditës. Fillimisht informoj të gjithë ata të cilët janë akter në përpilimin e rendit të ditës dhe i informoj rreth planit të kuvendit të gjithë e kemi miratu për çdo vjet. Tash është në domenin e tyre që ti sjellin apo mos t'i sjellin pikat, po konsideroj që ka qenë fushata noshta ajo ka qenë arsyeja, po ju bënë një kërkesë e në seancën e radhës të na vije një informatë e tillë, sepse është e domosdoshme.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Më bënë përshtypje të marr një informatë ku qëndron problemi me ujin e pijshëm. Tash me ndërtimin e ujësjellësve në fshatrat Smirë dhe Verban, nëse ka mundësi një informatë për këtë: pse tregu i kafshëve nuk kthehet në vendin ku është investu? Që dy vite radhazi dhe është marrë vendim i kuvendit komunal që të kthehet, mirëpo prapë qëndron atje. Më intereson atje përball shkollës të re është një ndërtim, ka mrri në 6 kat, na duhet një informatë, a ka leje për at ndërtim që është duke u bërë, sepse na dimë që në atë hapësirë nuk ka mundësi të punohet ose sipas planit urbanistik nuk lejohet përmbi 3 kate të shkohen ndërtimet, mirëpo e dimë që aty ka kalu edhe i 6-shti kat.

z.Samet Idrizi: Të nderuar të pranishëm, unë dua ti ngris tri çështje. Nën një. Para stacionit të ish-veterinaries nënstop është një qytetar i pandërgjegjshëm që hudh berllog aty. Unë shpesh dal edhe e largoj, unë kam propozuar më herët me vendos kamera mobile aty, ku qytetarët në vazhdimësi i dëmtojnë objektet publike ose i hudhin mbeturina ku ne investojmë. Kemi rasat ku shumë herë i kanë dëmtu ulëset, kockat e shumëçka tjetër. Çështja tjetër, një ditë kam ec në drejtim të varrezave të dëshmorëve, aty janë tu riparuar varrezat e dëshmorëve prej objektit të "Hidromoraves" e deri të varrezat e dëshmorëve në krahun e djathtë, ku është trotuari ki berllog aty shumë në pesë a gjashtë vende hudhet berllog. Aty ne i kemi do punëtor që punojnë, i paguan komuna dhe një organizatë e huaj ka shumë punëtorë që punojnë për mirëmbajtje. Është mirë me i angazhu në atë drejtim, sepse është tmerr aty sa mbeturina janë. Dhe çështja e tretë që dua ta ngris, është rruga prej të shkollës e mesme gjimnazi këtu, deri në Binç, që është riasfaltuar. Krahi i majtë ka të shkon për Binç është hudh rërë aty, po nuk është rigjesh mirë, ka marrë shumë keq dhe tash zalli aty shumë i shkapërderdhur paraqet rrezik. Personalisht me ka ndodh mu dy tri here. Është mirë në këto çështje me intervenu.

z.Vehbi Rama: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kanalizimi ka fillu që është bërë thuaja se ma zi se autostrada që gjashtë vite në fund ka fillu ka rruga "Regjep Bislimi", po kanë qenë dje do banor janë anku, që fatkeqësisht edhe pse është gypi që është privat dikun Fi 200, çka është me intereson, që krejt ky kanalizim ka derdhet në gropë septike, prapë ish ajo pronë private. Të keni kujdes, ju e dini sigurisht me emër e mbiemër që në pronë private ajo është e shenjet, nuk lejohet gropa septike të jetë në ta. Kame pyetje tjetër për drejtoreshën e Arsimit, e kam kërku që vitin e kaluar që të shkolla fillore të jetë një patrollë e policive, se aty vozitet shpejt, sidomos të shkolla "Dëshmorët e Vitisë. Më ka premtu që do të bisedon, do ta bëjë, po nuk e ka bërë ndoshta ka harru.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe unë sot kam më shumë kërkesa se sa pyetje. Të ndërtesat që janë të marume, disa para luftës, janë në një gjendje të mjerueshme, e objekti i Komune së Vitisë është bërë një objekt që perime me pa në shikim të parë është i mrekullueshëm. A keni naj strategji që edhe ndërtesat në të cilat jetojnë qytetarët e Komunës së Vitisë me u bërë në të njëjtën formë, se edhe ato e meritojnë nëse qeveria komunale si qeveri e bënë objektin e vet më shumë komoditet dhe mu ni shumë mirë. Unë besoj që edhe qytetarët e Komunës së Vitisë e meritojnë të njëjtin trajtim, prandaj pyetja ime është: a keni naj strategji që edhe ato objektet ndërtesa të bëhen të njëjta llojit qyshe është bërë objekti i komunës, apo fare për këtë nuk keni mendu? Për drejtorin e Shëndetësisë: a kanë përfundu hetimet për ambulanten e Gushices dhe a keni plan që të filloni ta ndërtoni atë ambulant apo fare nuk keni mendu? Dhe pyetja e tretë është pak më e ndjeshme, dhe nuk e di qysh janë mundësitë. Në kohën e sodit ka shumë persona të cilët po vuajnë nga sëmundja e kancerit. Nuk e di unë qysh janë mundësitë që me e kontraktu dikan, një person i cili është adekuat, që edhe është kërkesë legjitime që një ditë me ja kushtu në

Viti trajtimit të tyre, me e kontraktu një person i cili është specialist i asaj pune dhe me lanë një ditë, p.sh. të bëjë sepse ata kanë nevojë, po i shofim kushtet përgjithësi se çfarë kushte janë. Fatura është bukur e shtrejt, kështu kisha kërku që me punu në at drejtim, me e kontraktu një njeri adekuat që së paku një ditë, një herë në javë të trajto ata persona në qendrën e Vitisë, sepse ata kanë me shku ose ne Prishtinë ose me larg. Unë mendoj që është mundshme, vetëm duhet me ekzistuar vullneti.

z.Taulant Haxhiu: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Dashta të lidhem rreth vendimit që e keni marr për fletushkat. Fletushka është një mjet i informimit, i cili i lajmëron qytetarët për zbritjet në ditët e caktuara. Unë vij nga biznesi, nëse një market ka një vaj që është esencial, artikuj i domosdoshëm ose mill, në fillim të muajit del me zbritje, qytetarit përmes fletushkës informohet për zbritjen e artikujve të caktuara, që janë esenciale dhe të domosdoshëm. Tash në fillim të muajit i marrin rrogat dhe nëse një pako vaj ka kushtu 13 euro, në fletushkë lajmërohet që është 9 euro. Një qytetar mundet se paku 4 euro të bënë kursim me një artikuj të domosdoshëm. Unë e pranoj një vendim që fletushkat mos të vendosen në vetura e të ndotet ambienti, po të bëhet një rregullore që të vendet e caktuara të shpërndahen fletushkat. Fletushka është trendi më i ri i marketingut, trend botëror që praktikojnë të gjitha vendet e Evropës. Sa vende i kam vizitu, unë e kam pa që është një trend i ri i fletushkave, është një mjet i mirë i informimit. Vendimin që e ka marr drejtori i Inspeksionit, për mu është i papranueshëm. Unë kam edhe një kërkesë. Në seancën e kaluar kemi qenë në proces zgjedhor dhe disa drejtor ishin të ngarkuar me fushatë. Kam kërku prej drejtorit, Nexhmedin Jakupi, të rruga "Adem Jashari", mbrapa banesave, është mirë ta viziton. Unë kam kërkesë prej banorëve, aty është komplet ambienti i ndotur, ka shiringa, ka mbeturina dhe atëherë e kam edhe aty duhet të intervenohet, të pastrohet, për shkak se jetojnë një shumicë e madhe e qytetarëve. Nëse nuk merrni veprime, unë masi aty jam kanë shumë i votum, e marr vet e pastroj. Është mirë të shikoni këtë. E kam pas një propozim unë, është seanca e dhjetë që e ceku, propozimin për ditën e Diell të jet ditë pushimi. Unë e kam propozim këtë, e ku shumica me kanë thanë që është një propozim i mirë dhe e përkrahin. Ne e kemi pas një diskutim të mirë me bizneset, 85% ose 90% e kanë pranë këtë, po drejtori, z.Skenderi, nuk ka marr asnjë vendim, as nuk e ka sjellë në kuvend propozimin, pastaj kuvendi ta vendos që ta kemi të Diellën pushim.

z.Ali Bajrami: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Takimi i fundit që po e quajmë takim të progresit, ku kanë qenë kryetari, nënkryetari, drejtori i Financave me CDI-në, sa i përket çështjes së ujit të pijshëm në Komunën e Vitisë, kisha kërku një informatë shpërndarë, çka është diskutu dhe çka është në të ardhëm parapa, që këta ujësjellës të funksionalizohen.

z.Ibrahim Rama Drejtor i Financave: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Keni dy pyetje që kanë të bëjnë me problematikën e ujit të pijshëm në Komunën e Vitisë. Po ju jeni në dijeni, që të Hënën e kemi mbajtur një takim me të gjithë akteret që kanë të bëjnë me ndikimin e tyre në përmasimin e ujit të pijshëm, gjegjësisht sistemin në tërësi në territorin e Komunës së Vitisë. Kanë qenë CDI-ja implementuese e projektit "Hidromorava", si kompani regjionale që ka të bëjë me ujësjellësin dhe Komuna e Vitisë si përgjegjëse për furnizim me ujë për qytetarët e Komunës së Vitisë. Disa problematika janë ngrit, disa vendime janë marr aty për aty, kanë qenë edhe përfaqësuesit e fshatrave që kanë të bëjnë me problematikën e ujit, kryesisht një pjesë e problemeve që kanë të bëjnë me komunën, d.m.th me financimin e komunës, që e ka për detyrë me i plotësua këto projekte në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara në vitin 2012. Ju e dini që të gjitha vendimet që i kemi marr me i plotësu këto marrëveshje që kanë të bëjnë me ujësjellësin, janë marr në Kuvendin Komunal dhe deri me tani për hir të realitetit, jeni në dijeni që kemi pagu 230 mijë euro për marrëveshjet që i kemi trashigu. Lidhur me përfundimin e ujësjellësit në Komunën e Vitisë dhe 125 mijë euro jemi në përfundim të marrëveshjes, që ka të bëjë me finalizimin e ujësjellësit në fshatin Stuball. Gjitha këto aktivitete që i përket komunës na i kemi plotësua në kuptimin financiar, kurse implementuese e projektit ka qenë CDI-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe "Hidromorava" si përgjegjëse e këtyre projekteve. Që në fund të fundit, këto projekte kur të behet pranimi teknik, "Hidromorava" i merr përsipër si aset

të saj dhe ajo masanej fillon me menaxhimin dhe sipas nevojës edhe me rehabilitimin e këtyre ujësjellësve. Gjithnjë këto po i ceku deri tek problemi, që pjesa e të gjitha këtyre projekteve nuk ka përfunduar, d.m.th uji i pijshëm nuk rrjedh në shtëpinë e qytetarëve të Komunës së Vitisë dhe këtë shqetësim përherë e kemi ngrit edhe ju e kemi ngrit dhe në fund kemi vendos për hir të shumë takimeve që i kemi pas me këta akter, që kanë të bëjnë me implementimin e ujësjellësve dhe të hënën definitivisht e kemi mbajtur takimin dhe kemi marr obligime që me i përfunduar këto ujësjellëse, është fjala për pesë fshatra, dy Sllatinat, dy Sadovinat dhe Tresteniku që ka përfunduar. Ju e dini që sistemi është në gjende të rregullt, është bërë pranimi teknik, është testu, pastaj i kemi dy sisteme të ujësjellësit që kanë të bëjnë me fshatin Smirë dhe Verban, edhe ato sipas informatave janë të përfunduara si rrjet, pastaj kemi sistemin e ujësjellësi për fshatin Goshicë dhe Germovë, dhe është në implementim e sipër projekti i ujësjellësit në Stubëll dhe kontrata është lidh edhe për tri fshatra që duhet mu rehabilitu, që e kanë ujësjellësin, është fjala për Beguncën. Skifteraj dhe Zhitin dhe katër të tjera. Na kanë thanë që së shpejti do të hapet tenderi apo thirrja publike që me gjet një operator që me i implementu këto, me rehabilitu. Ajo çka është me rendësi duhet me rrjedh uji në shtëpitë e qytetarëve, konsiderohet një projekt i përfunduar mirë dhe në këtë drejtim, në mbledhjen e fundit është diskutuar dhe është marr përsipër, që pjesën e obligimit që e kanë qytetarët dhe “Hidromorava” dhe CDI-ja ta marrin së bashku dhe në ditët në vijim të merret një vendim i prerë si të vendoset për këto sisteme të ujësjellësit. D.m.th ne kemi kërku që uji duhet me rrjedh nëpër shtëpitë e qytetarëve, decidiv ka qenë kryetari dhe qeveria komunal me këta akter dhe është marr vendimi, janë marr përgjegjësi, CDI-ja e ka shprehur një mundësi për qytetarët, i ka dhuruar dikur 3000 orë matës, që do të vonohen nëpër shtëpitë e qytetarëve, d.m.th një ndihmesë në kuptimin financiar. Pjesën tjetër të implementimit të kyqjes së qytetarëve në këto ujësjellës, do ta bëjnë qytetarët së bashku me “Hidromoraven” përmes thirrjes publike, që do të zgjedhën kompanitë përkatëse, që janë të specializuara me i implementu këto kyqje të fshatrave dhe unë besoj që së shpejti do ta shifni në teren. Po prapë do të varet prej përfaqësuesve të fshatrave, sa do të jen azhur në këtë drejtim me “Hidromoravën”, që këto grupe punuese dhe kompani që do ta përzgjidhen, që të fillon kyqjen e tyre qytetarëve në sistemet e ujësjellësve që janë të gatshme, është fjala për pesë fshatra, dy Sadovinat, dy Sllatinat dhe Tresteniku, Germova Goshica Verbani e Smira, d.m.th në këtë drejtim kjo kish me qenë si informatë vija të trasha, që ka të bëjë me sistemin e ujësjellësit në komunën e Vitisë.

znj. Fatbardha Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishme! Sa i përket pyetjes së parë, për fillimin e vitit shkollorë, edhe pse përmes mediave të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë janë të njoftuar për fillimin e vitit të ri shkollor, por edhe ne formë të shkruar mund të ja sjellim në seancën e ardhshme. Sa i përket ecurisë dhe fillimit, gjithëkë ka shku në mënyrën me të mirë të mundshme, edhe pse ka qenë një vit jashtëzakonisht i ran, tu e ditë rënien e numrit të madhe të nxënësve dhe normave të mësimdhënësve. Në aspektin infrastrukturor, të gjitha shkollat që kanë qenë të planifikuara me planin dinamik të rivitalizohen për fillimin e vitit të ri shkollorë 2019-20, me datën 20 Gusht kanë qenë të përfunduara. Po ashtu pajisja me inventar, mjete të tjera sipas kërkesave të shkollave, kanë qenë në kohën e parapamë, kemi pas me disa operator të mjeteve tjera pak telashe, po edhe ato janë rregullu në momentin e duhur dhe konsideroj që fillimi i vitit të ri shkollor ka qen i mbarë dhe ju uroj të gjithëve sukses. Sa i përket pyetjes tjetër, për shfrytëzimin e sallës së sportit në shkollën e mesme profesionale “Januz Zejnullahu”, dihet që Komuna e Vitisë e ka vetëm një sallë sportive, atëherë komuna në bashkëpunim me shkollat dhe drejtorin e Kulturës, ka gjetur një modalitet që disa klube që kanë bërë kërkesë ta shfrytëzojnë këtë hapësirë. Këshilltarja e nderume, profesoresha ka kërku qasje në dokumente zyrtare. Sa e di unë, e ka marr informatën përmes Zyrës për Qasje në Dokumente Zyrtare dhe marrëveshjen që e ka klubi me shkollën për shfrytëzimin e sallës, ne e dimë që ajo sallë është e shkollës, po në mungesë të infrastrukturës shkollore që kanë shkollat tjera dhe sallës që është nivel komunal, e vetmja sallë, atëherë duhet me bërë zgjidhje, nganjëherë edhe me ju ofru mundësi klubeve që me pas qasje me e zhvillu aktivitetin sportiv, sepse është në të mirë të rinisë, të nxënësve dhe në të mirë të qytetarëve të Vitisë.

Nuk shoh ndonjë pengës për shfrytëzim të kësaj salle. Sa i përket pyetjes për siguri në komunikacion, e di që në ngrit këtë çështje, edhe unë e kam ngrit në KKSB, është kompetent ekskluzive e policisë për me patrollu këto rrugë dhe për me shtu sigurinë në rrugë. Ne si drejtori e Arsimit e kemi diskutu për shkak se edhe aty edhe te gjimnazet momentin e fillimit të ndërrimit të orarit të mësimi, bëhet një kauzë dhe me që është rrugë kryesore, krijohet pasiguri. Ne do të bëjmë prap presion, ama nuk është nënë kompetencën tonë që të vnojmë polic në rrugë.

z.Skender Ahmeti: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Patëm disa pyetje, si çështja e ndërtimit të shkollave mesme, që fatkeqësisht i ka tejkalu lejen ndërtimore, sepse e ka për katër kat dhe për këtë tejkalim ne kemi qenë disa herë në inspektim së bashku me asistencë, edhe me polici i kemi ndërpre shpeshherë punimet. Për këtë çështje kemi komunikua edhe me prokurorin, kemi ngrit kallim penal, kemi marr edhe vendim që e kemi qu në gjykatë dhe investitori naj ka bërë një ankesë për masat që i kemi marr për procedurën administrative dhe lenden e kemi qu prap në Ministrinë e Planifikimit Hapësinorë dhe çështja është në procedurë administrative, gjyqësore dhe penale. Kemi qenë që nuk kemi nejt duart kryq. Sa i përket hedhjes së mbeturinave te stacioni ish veterinarisë, na personin nuk e dimë se kush është, megjithëse i kemi shtu angazhimin shtesë, po na duhet ndihma jo vetëm e asamblistëve po edhe e qytetarëve nëse ka ndonjë dëshmi, e ku ne jemi kanë të gatshëm, menjëherë ta procedojmë çdo kush që e shkel Ligjin për Mbeturina. Një çështje që e përmendi Taulanti, at të fletushkave, të cilën ne e kemi marr një hap e jo vendim, e kemi bërë një njoftim publik për të gjithë bizneset që punojnë në Komunën e Vitisë, që nga data 1 Nëntor 2019 do të fillojmë ta implementojmë udhëzimin administrativ për ndëshkimin me gjoba mandatore dhe Ligjin për Mbeturina e rregulloren komunale për mjedis që e ka Komuna e Vitisë, dhe ky udhëzim është i vitit 2018. që të sanksionohet të gjithë ata operator ekonomik që hudhin fletushka vend e pa vend në qytetin e Vitisë dhe përreth. Kjo gjë është e sanksionuar me udhëzim administrativ të nenit 16, ku thuhet se të gjithë ata që hudhin fletushka, broshura jashtë vendbanimit, jashtë vendit ku e cakton kuvendi komunal, sanksionohet me këtë udhëzim administrativ. Ne si inspektorat nuk jemi të thirru me interpretu apo me e komentu një udhëzim apo një ligj, se a është i mirë apo nuk është, po ne e kemi për obligim vetëm me ekzekutu dhe në këtë rast nuk dëshiroj që Komuna e Vitisë të mbetet me zero gjobe ndëshkim mandatar në nivel vendi, ku komunat tjera kanë fillu ta zbatojnë kështu çështje dhe në do ta bëjmë këtë kërkesë. Kemi pas edhe nga asamblistët e këtij kuvendi, që të ndërmarrim masa që t'i ndërpresim këto operacione. Kemi mbështetjen ligjore dhe kjo është e sanksionuar qartë dhe shkrun në udhëzimin administrativ për ndëshkime mandatore, e ki nenin 16. Sa i përket çështjes së respektimi të orarit për bizneset që operojnë në Komunën e Vitisë, që ju keni qenë iniciator që e diella të behet ditë pushimi, ne i kemi marr disa hapa procedural, ku në fund kemi pas debat me bizneset, ke qen edhe ti Taulant. Nuk ka qenë një koordinim apsolut, ka pas pro dhe kundër që mos të behet kjo punë, po megjithatë për shkak të fushatës që ishte zgjedhore, ne e kemi pauzu, e kryetari insiston me çdo kusht me bërë këtë. Po prapë se prapë edhe nga përfaqësuesit e kuvendit komunal edhe nga bizneset, nuk janë me një fjalë, po megjithatë ne do të sjellim në kuvend dhe të gjithë ata që kanë vërejtje me shkrim me i inkorporu në këtë rregullore. Ne do t'i implementojmë. Tek çështja e tregut të kafshëve, ne pas kërkesës që kryetari ta bej dislokimin e tregut nga ish tregu në tregun e ri, kemi kërkuar që të plotësohen disa kushte. Kemi kerku që të ketë ujë, peshore, rrethoj me të mirë dhe këtë e kemi bërë, hapjes e pusit, që d.m.th ujë ka për momentin. E kemi bërë edhe pastrimin fizik të tregut, do ta shiqojmë mundësinë, sepse edhe "Ekohigjina" nuk është në nivelin e mirë të menaxhimit të tregjeve, sepse ne tash kur ta bëjmë dislokimin nga tregu i vjetër në të riun, duhet me pas kushte me të mira, ndoshta ekziston mundësia të jepet në partneritetet publiko-privat, për shkak të menaxhimit më të mirë të tregut të kafshëve.

z.Ajet Sallahu Drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket pyetjes për planin zhvillimor komunal për vendimin që është marr me herët, që të fillojmë me punë kemi fillu me kohë punën janë majt disa diskutime publike me grupet punuese. Kemi pas edhe një marrëveshje bashkëpunimi edhe me GIZ-in për me bërë bazën e të dhënave, raportet sektoriale, janë grumbulluar të gjithë me institutin e planifikimit hapësinorë, kemi kërku ndihmë

prej tyre dhe jemi duke punuar bashkërisht, mirëpo është sfidë e madhe në hartimin e hartave për planin zhvillimor komunal dhe nga komuna janë nda mjete për angazhimin edhe e një kompanie konsulente për me e përfunduar planin zhvillimor.

Z.Basri Aliu Drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket hetimeve rreth AMF-së ne Gushicë, pasi që është kompetencë e organeve tjera, ne ende nuk kemi asnjë raport nga ta dhe nuk kemi mundësi të ndërhyjmë në këtë drejtim. Sa i përket trajtimit të të sëmurëve me kancer, që është shqetësim i të gjithëve, po të caktohet një ditë që ata të vizitohen, ne jemi çdo ditë në teren, ekipet mjekësore çdo ditë aty ku ka nevojë shkojnë intervenojnë për ato mundësi që janë kompetencë në Qendrën e Mjekësisë Familjare, pasi që komuna merret vetëm me mjekësinë primare, ndërsa për trajtimin tjera janë kompetent mjekësia terciare, prandaj kështu që çdo ditë ekipet shëndetësore janë në teren aty ku ka nevojë.

Z.Hasan Aliu nënkryetar: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Drejtorët u përgjigjen në pyetjet, po drejtorët Shërbimeve Publike nuk të koka këtu e unë e morra fjalën. Ke pyetja që kanalizimi ka fillu dhe u tha që gropa është pronë private. E kemi këtu drejtoreshën, e cila do ta shikon dhe ne seancën e ardhshme ju sjell informatë. Pyetja tjetër tek varrezat e dëshmorëve, ka shume bërlllok dhe duhet me ja dhënë detyrë drejtorit të Shërbimeve Publike që ta shikon këtë. Pyetje tjetër ishte pastrimi i banesave përball policisë, edhe këtë pyetje do të ja përcjelli drejtorit. Tek ndërtesat e ndërtuar para luftës, ke një pyetje, po nuk kam përgjigje për këtë, mirëpo prej provojës që kam ndoshta të gjitha banesat janë privatizu, nuk ka banesë ma të komunës, tash tretmani i përgjithshëm i tyre, dukja e jashtme, nuk kam informata për këtë.

znj.Mirlinda Sadiku: Drejtoresha e përmendi që nuk e ka problem me shfrytëzimin e sallës, absolut as unë aq me pak kur vij nga fusha e sportit, mirëpo unë e kam problem me menaxhimin e sallës momentin që këto që nënashkruhen. d.m.th përgjegjësia, menaxhimi bjen mbi juve. E dini që gjashtë herë është ndërru qelsi. pse është ndërru herën e fundit është thy edhe me forcë, d.m.th nuk po menaxhohet mirë. Mund të ju tham një numër të madh të dëmtimeve që janë bë, nuk e përjashtoj mundësinë edhe të nxënave, mirëpo unë vet kam pësuar prej mos pastërtisë, për shkak që nuk është tu menaxhu mirë. Të jesh e bindur për këtë, absolut nuk jam kundër klubeve që të ushtrohet aty, mirëpo menaxhimi sa i mirë, papastërtia është evidente, demet që janë bë e nuk janë riparuar, që parashihet në kontrate e keni pa edhe ju, nuk ka orar aty, orari do të duhet të postohet aty dhe demet që janë bë tash. neve na imponohet, p.sh.: orën e basketbollit, elementet teknike, ndoshta janë dëmtu e nuk janë rregullu. Unë nuk jam kundër zhvillimit të sportit në Komunën e Vitisë, e di që është vetëm ajo sallë, mirëpo menaxhimi nuk është në nivelin e duhur, pse nëse vazhdohet kësi soj, është e pamundshme me mbajtë mësim aty nga papastërtia. Unë kërkova ta angazhoni një punëtor teknik me kontratë mbi vepër, p.sh.: për 9 muaj sa zgjatë procesi mësimorë.

Z.Taulant Haxhiu: Drejtor, a keni ndonjë vend të caktuar se ku të shpërndahen tash fletushkat që të informohet qytetari, ku duhet ai ta marr një fletushkë, një zbritje të një artikulli, ju e keni ndalu nëpër qytet, a keni bisedu që ku mundem të informohem na. Për diskutim publik që kemi bë, për rregullore për orarin e punës, për bizneset, unë at ditë jam kanë prezent, 95% të bizneseve janë kanë pro, vetëm një persona ka qenë kundër, ka qenë një nga shoqëria civile, Mentor Rexhepi, i cili nuk ka pas biznes asnjëherë, ky ka qenë kundër, sepse nuk ka përvojë në biznes.

Z.Skender Ahmeti drejtor: Unë jav jap udhëzimin administrativ, e kame me veti. Si mos të kishim bërë juridike ne nuk e kishim marr këtë hapë, se unë e di që ju keni reagu edhe në portale dhe keni kërku që kryetari ta ndryshon këtë vendim absolut. Unë jam i bindur 100% që kryetari Haliti nuk e dinë që unë e kam marr këtë hapë për me zbatu një ligj dhe një udhëzim, prandaj Ligji për Mbeturina dhe akti nënligjor që derivon nga ky ligj e specifikon qartë. Po mos ta kishim këtë, unë absolut nuk do ta kisha bë as njoftimin publik. Në aspektin procedural, të gjitha bizneset që veprojnë në Komunën e Vitisë i kam njoftu me shkresë, jav kam dhënë njoftimin dhe e kanë pranuar. Tash e kemi mundësinë, teknologjia ka hec, janë portalet, televizionet, përdërisa udhëzimi administrativ e

ka nxjerr qeveria e juaj që ka qenë në udhëheqje, prandaj shfrytëzoj rastin që nga nesër me 1 Nëntor, të gjithë operatorët që hedhin fletushka, ne do ta sanksionojmë. Fletushkat le të shpërndahen në televizione, portale, unë jam përcjellë nr. e udhëzimit, Udhëzimi Administrativ MMPH NR.06/2018 për ndëshkimin me gjoba mandatorien 16 për masat ndëshkimore, i cili thotë, në të cilat vende ku hedhen broshurat, fletëpalosje jashtë vendeve të përcaktuara nga komuna, sanksionohet me gjobë.

z.Sejdi Emini: Është propozim që pikërisht e kam dhënë unë, propozimin e kam dhënë me arsye, sepse i kemi disa biznese të mëdhaja që e kanë pushtu tregun në krejt Kosovën, si ETC, VIVA, INTEREX. Leje që e kanë pushtu tregun, që është e drejtë me bërë tregti, mirëpo i kanë mbytur edhe krejt bizneset e vogla në Komunën e Vitisë. Tash qaq shumë na kanë bërë dëm, po na lënë edhe mbeturina. Unë mendoj që të gjithë duhet me u kanë një zë, që mos na leju atyre me na dëmtu. Tash edhe ambientin që po e pastrojmë ata po e ndotin.

z.Taulant Haxhiu: Sejdi, unë edhe pse bashkëpunoj me bizneset e mëdhaja, nuk po du me i mbrojt ata që i cekun dhe, nuk është interesi im personal, po unë po marr ankesa nga qytetarët dhe nga marketet, që me se paku 1 kilometër nga 140 punëtor. *Mediterran, Emi Center*, ata kanë thanë që na gjithmonë qesim fletushka dhe tash me këtë ndalim që e ka bërë drejtori, unë jam tu i mbrojt bizneset e Vitisë. U tha që kemi rrjetet sociale, kemi qytetar që nuk kanë rrjet social, e fletushka është trend i ri në krejt Evropën, mënyrë me e mirë e informimit.

z.Hasan Aliu nënkryetar: Unë mendoj se janë dy të cilat e kanë at kahjen shumë pozitive, tu fillu edhe propozimin që e ka bërë drejtori, po edhe këshilltari që e ka arsyeshmerinë e vet, nëse ne në momentin e atij vendimi me një nen të posaçëm të kish thanë që të gjitha fletushkat ne Viti mund të lihen në X vendin, dallon televizionin nga ajo që po e kërkon Talanti. Unë jam që te këtë një vend që ku qytetarët të shkojnë t'i shohin fletushkat.

z.Jakup Demiri: Përsëritet të nderur të pranishëm! Rregulloren dhe ligjin nuk e di, po në aspektin ekonomik ne që jemi ekonomistë e dimë se si bëhen këto. Nuk ka të drejtë një ligj të ndalojë këtë broshurën për njoftim të qytetarët. Edhe në përfundim është kjo, mirëpo ligji munde të ngarkoj opozentët ekonomik që të paguajnë një pjesë të përqindjes edhe për këtë që shkakton mbeturina, sepse broshura është trend botëror dhe duhet të bëhet reklama me broshura.

z.Bekim Azizi: U bë temë diskutimi kjo, pat gjëra të mira dhe të këqija, mendoj që drejtori duhet me i respektu rregulloret, mendoj që edhe të tjerët duhet me i respektu të drejtat, mirëpo këtu nuk guxojmë me i diskutu emrat e bizneseve, sepse i bjen se ne këtu në kuvend po e favorizojmë një biznes ose televizion. Nëse drejtori ka bërë një vendim, është mirë në seancën e ardhshme të na sjell në kuvend, ta shohim edhe na e qe është nevoja të ndryshojmë ose plotësojmë dhe vendimi të jet me konkret, sepse edhe unë jam që fletushkat mos të lihen në vetura e ne vende që ndotin ambientin, sepse janë të tepërta.

z.Skender Ahmeti: Krejt e kuart, unë thash nuk kam marr vendim, sepse po të marr vendim në fillim do ta sjell në këtë vendimin. Unë e kam marr një hap për me e zbatu një udhëzim dhe një ligj. Të njëjtin gjë mendoj që nga data 1 janar 2020, mendoj që të gjitha bizneset që nuk kanë kontrata për menaxhimin e mbeturinave, me ju bërë të njëjtin mundësi me pas kontrata, se përndryshe po i gjuajnë mbeturinat vend e pa vend, prandaj edhe kjo është e parapamë me Ligji për Mbeturina dhe me udhëzimin administrativ. Hapi i par është ky që e kemi marr, e hapi tjetër do të jet ai. Kemi rastë kur të bëhet shpërndarja e fletushkave që qesin me shumicë në tokë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Për seancën e nëntë të rregull të Kuvendit Komunal të Vitisë, kemi parapa këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Kuvendit Komunal të Vitisë.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-shtator 2019
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për shpalljen në diskutim publik për propozim rregulloren për transparenten në Komunën e Vitisë.

A ka dikush rreth rendit të ditës?

Nënkryetar z.Hasan Aliu: Të nderuar këshilltar, piken e katër të rendi të ditës e kemi ndryshim plotësim të vendimit të KKS-së. Dje na ka ardh një kërkesë nga FSK-ja, të cilët dëshirojnë që përfaqësuesin që e kanë në KKS ta ndryshojnë, andaj unë kërkoj që të futet në rendë ditë edhe ndryshim plotësimi i vendimit të KKS-së, d.m.th që kemi të bëjmë me përfaqësuesin e FSK-së, pasi që dje na ka ardh kërkesa nuk kemi mujtë të përgatisim propozim vendimin. Nëse jeni ju pro, kërkojnë nga Zyra e Sekretarisë së Kuvendit Komunal ta bënë vendimin.

Kryesuesi, z.Naim Pira: A ka dikush rreth rendit të ditës. Pasi që nuk ka e qes ne votim miratimin e rendit me propozimin e nënkryetarit. Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Kuvendit Komunal të Vitisë

A ka dikush rreth pikës së parë të rendit të ditës ju lutëm? Pasi nuk ka e hedhim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatohet se me votat e të gjithëve u miratu rendit i ditës, kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-shtator 2019

z.Ibrahim Rama: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Si zakonisht në periudhën tre mujore. Drejtorja për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim ka për detyrë të raportoj mbi ekzekutimin e buxhetit për periudhën në fjalë. Këtë herë është fjala për ekzekutimin e buxhetit për periudhën janar-shtator të vitit 2019, ashtu siç është ekzekutimi buxheti, ashtu janë edhe shënimet e nxjerra. Kështu që, të gjitha këto paraqesin në mënyrë të saktë ekzekutimin apo me mirë me thanë shpenzimin e buxhetit që kanë ndodh për këtë periudhë. Në tërësi sipas këtyre pasqyrave, shifer që buxheti i alukuar për vitin 2019, gjegjësisht për këtë periudhë është 9 milion e 37 mijë. Nga kjo shumë janë shpenzu gjithsej 7 milion e 950 mijë apo shprehur në përqindje duket si vijon: për kategorinë e pagave është shpenzu 99.95%, për shërbime dhe mallra 85%, për komunal 93%, për subvencione 90%, për investime kapitale 58.51% dhe në tërësi në komunal buxheti është shpenzu nga vlera e alokuar në përqindje prej 87.97%. Në vazhdim të pasqyrave financiare i keni qysh është shpenzu buxheti sipas drejtorive, dikun sillet përqindja mbi 90%, përveç në Drejtorinë për Financa që është dikun 58%, ndërsa të gjitha drejtorit dhe zyra e kuvendi janë në përqindje të larta. Sa i përket të hyraave vetanake këtë vit jemi rekord në krahasim me vitet e tjera. Pra duke e krahasuar gjithë periudhën e paflutës prej vitit 1999 deri më sot asnjë herë nuk kemi pas grumbullim të hyrave vetnake më shumë se këtë vit edhe përqindja paraqet që jemi në 108.8% krahasim me planin vjetor të grumbullimit të hyrave vetanake. Materialin e keni marr më kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

znj. Mirlinda Sadiku: Drejtor, p.sh.: 63 mijë euro vendime gjyqësore nuk janë pak, kur të ja shtojmë edhe atë investimeve kapitale 57 mijë euro, nuk jeni bash mirë me ligjin, me u pas kanë mirë me ligjin nuk ka pas nevojë me qenë qeto vendime gjyqësore hiq, d.m.th njerëzit me ekzekutu të drejtën e vetë ligjore që ja përcakton kontrata kolektive, ata duhet me i marr paret e tyre që ju takojnë pagat jubilarë çdo 10 vite shërbim në arsim dhe pensionim që ju takojnë tri pagat e fundit, prandaj ata nuk i kanë marr me kohe dhe normal që ju kanë drejtu gjykatave e që duhet me i pagu komuna. At shqetësim që e kam ngrit po më duket prej fillimit të mandatit, që Vitia mos të diskriminohet me buxhet, fatkeqësisht edhe dje e dokumentuan edhe portali koha.net, që është mjaft i besueshëm, ku fatkeqësisht bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave që e kam pas ngrit si çështje qyshe në Mars kur u bënë përgatitjet e para për buxhet, imagjinone për Komunën e Graçanices ndahen 1176 euro për kokë të banorit, ndërsa në fund të listës është Komuna e Kaçanikut, Dragashit, Rahoveci dhe Vitia. Prandaj jemi diskriminu. së e kontestojshin ju, prandaj kjo po e argumenton at të kundërtën, që Vitia është diskriminu me buxhet, e të pasqyrat

financiare mu ma merr mendja që krejt çka mundem ne me diskutu, se pagat, mëditjet, shërbime mallra janë të destinuara. Krejt çka mujmë me fol, janë për investime kapitale, që janë rreth 2 milion e 100 mijë euro, po megjithatë po me intereson drejtor, pse nuk ka shpallje për bursa për studentet. E keni parapa në buxhet, drejtoresha e Arsimit dhe nënkryetari thojnë që shkon me vit akademik, e viti akademik fillon me 1 Tetor 2019-20 dhe asnjëherë studentët e Vitisë nuk i marrin bursat me kohë. E din shumë mirë, këtë vit shpallja ka qenë në nëntor, ndërsa bursat i kanë marr në Maj ose Qershor. D.m.th diçka qetu po ngec. Mirë që ka dal komuna, mirë ama këtë vit edhe planifikimi ka qenë më i vogël, ashtu na ke thënë ti, prandaj në krahasim me planifikimin dhe planifikimi është me i vogël normal që keni dal më mirë, po kur të ja shtojmë edhe at që keni mbet borxh vitin e kaluar, një 300 mijë euro, atë nuk qëndroni edhe bash mirë. Po më intereson ta di të rriturat e inkasimit i të hyrave, ligji në fuqi që është për me inkasu të hyrat me përmbarues privat, a është kjo që i ka dhënë efektet e para edhe në buxhetin komunal, sepse pikërisht ato pyetjet që i bënë grupi i VV-së e që kanë qenë shumë të arsyeshme, sepse shifrat që po jepen në mënyrë të akomolome, po krijohet një përshtypje që ka shumë kontrata mbi vepër. Po për mu është absurdë, p.sh.: furnizimi për zyrën, ditar shkolla, shkumësa, fletore pune dhe për shkollë, d.m.th këtu po ngec diçka. Drejtoresha sapo na thotë që viti shkollor ka fillu shumë në rregull, a këtu po thotë që ka pas mungesë të ditarëve, shkumësa, që është diçka jetike. Nuk mundesh me fillu vit shkollor pa pas ditar, pastaj kemi të Zyra e Kryetarit, nga kodi i tij buxhetor janë pagu pagesa për dezinfektimin e shkollës fillore. Shumë mirë, po më bëhet qefi, se në plan të prokurimit e keni parapa një shumë kogjo të madhe, po kur nuk po e realizoni. E qekjo shkollë te koka dezinfektu shume mirë, po mendoni edhe për një 20 shkolla tjera, se kanë nevojë për mu dezinfektu. Sa i përket investimeve kapitale kam pyetje se e keni paraqit këtu tek shuma komulative. Ekzekutimi i buxhetit qeto 57 mijë euro, a është borxh ndonjë operatori ekonomik, që është ekzekutu këtë vit, e ka mbet borxh si dhe shpenzimet e vendimeve të gjykatave i keni 63 mijë euro, nëse i mbledhim këto, del një shifër mbi 100 mijë euro. Kërkoj sqarim, këto i keni në faqe nr. 4 i kemi tri kode buxhetore që i referohen të njëjtës çështje, d.m.th ekzekutim të vendimeve gjyqësore. Po du me di që janë te tria kur i keni mbledh si shumë komulative apo kjo ka të bëjë vetëm për investime kapitale. E nëse investimeve kapitale ja shtojmë qeto 57 mijë euro, nëse i ka marr përmbaruesi privat, atëherë rezulton se investimet kapitale janë nënë 45%, sepse ato pare që janë kanë të përcaktume për investim kapitale, ato i ka marr tjetërkush, d.m.th punët në teren nuk janë kry, për atë vlerë prej 57 mijë euro, e shuma normal që i bjen me poshtë. Kam pyetje dhe kërkoj sqarim te mirëmbajtja e autorrugëve lokale, kanë qenë dikun rreth 68 mijë euro të planifikuara, mirëpo plus me taksa me krejt, kalon deri 84 mijë euro. Çka ka ndodhë? Çekjo shifër është rrit 109 mijë euro. Nëse e merr informatën? Është kodi 14032, te mirëmbajtja e automjeteve, këtë vit kam bërë shumë kërkesa në qasje në dokumente zyrtare po me ka interesu pse kaq shume mirëmbajtje të automjeteve, d.m.th dikun rreth 24 mijë e 188 euro, nëse nuk gaboj kanë qenë, kjo veturë e cila është bërë remont komplet vitin e kaluar, u rretullu ajo autoambulanca, u dësh mu rregullu, po këtë vit nuk u rrotullu asnjë autoambulancë, çka ka ndodhë, hej 24 mijë euro, me të vërtetë shumë, mos është me mirë me ble një veturë të re, se sa me i shpenzu taksat e qytetarëve për një veturë, 12 mijë euro një veturë me u ripar nuk është pak, singërisht nuk është pak. Te vendimet e gjykatave, me ka rastis me i këshyrë shumë buxhete komunale edhe kanë kod buxhetor. P.sh. Komuna e Lipjanit ku është e parapamë vendimet e gjykatave vit pas viti. Komuna e Vitisë është duke u përball me vendime të gjykatave, prandaj vet momentumi kur po merren qato pare me anë të përmbaruesit privat, komuna jet keq qaty, prandaj pse na nuk kemi që në buxhet me plotë të drejt se kemi dhënë vërejtjet tona e nuk i keni marr parasys, pse nuk e keni parapa një kod të veçantë për qeto vendimet e gjykatave, po tani po jesi keq ose investimet kapitale ose shërbimet dhe mallrat. Te shërbimet e varrimit e di që keni mbet mas, po me duket keni kogjo shumë borxhe si qëndron çështja këtu.

z.Bekim Azizi: Te shpenzimet kapitale, kemi pas me mi sjell edhe do informata. Drejtor, nuk mi ke pru, se të thash që nuk i ke pru asnjëherë shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit 11 mijë e 45 euro dhe 2481 euro akomodim. Qeto ki pas mi sjell si informata, nuk i ki sjellë, pasi që si ke pru besoj që i bjen. Shërbimet kontraktuese tjera, naj jep një informatë tashti të përgjithshme kodi 13460, 30 mijë e 625 euro derivate për vetura, është diçka shumë e lartë për këtë nëntëmujor. Po me intereson kodi 14230, shpenzime për informim publik, 13 mijë e 745 euro, që është diçka nëse krahasohet me vitet tjera, është jashtëzakonisht e madhe; dhe drekat zyrtare 27 mijë e 200 euro; edhe të vendimet gjyqësore. Dhe po me intereson te të hyrat vetanake të hyrat nga qiraja dhe hapësirat publike janë vetëm 2152 euro, janë të realizuara nëse ka një mundësi, një informatë për seancën e ardhshme me naj sjellë vetëm me shkrim, cilat janë ata që paguajnë dhe cilat janë ata që kanë obligime, cilat hapësira janë në shfrytëzim.

sepse prej 10 mije e 161 është planifiku për nëntëmujorë, d.m.th vetëm 2152 jeni minus 808 euro, janë obligime që nuk janë pagu. Te prezantimi analitik i investimeve për periudhën Janar-Shtatorë, kemi rregullim i lumenjve dhe proçkave. Te proçkat dhe lumenjtë Viti-Kabash-Smire, Drobesht-Beguncë-Viti, d.m.th janë përmendur vendet, por nuk e di që një lumë kalon në Smire që është intervenu aty, është mirë me keshyr këtë kontratë, at pranin teknikë që i kanë bërë, sepse në Smirë nuk e di që është bërë një intervenim te Lumi. Asfaltimet e rrugëve lokale "Rahovica Comerc" dhe "ProGrup". Të dyat janë që kanë kry do punime, kanë kry edhe në Smirë, a janë këto projekte dyvjeçare që po hinë, që kanë mujt mu kry vitin e kaluar dhe sivjet. Vendimet gjyqësore, a janë investime kapitale apo çka është bërë, apo vetëm janë marr paret nga investimet kapitale që ki pas më i bërë e kanë hi në këtë kod, sepse tek investimet kapitale i ki paraqit edhe vendimet gjyqësore, sepse në e dimë që vendimet gjyqësore nuk janë investime kapitale. Te krahasimi shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, nëse krahasohet me nëntëmujorin e vitit të kaluar dhe tash gati 100% ka rritje në shpenzimet e udhëtime jashtë vendit, këto shpenzime i kam bërë edhe vitin e kaluar, asnjëherë nuk mu kanë prurë. Krahasimi tek mirëmbajtja e rrugëve lokale është një krahasim madh, më nëntëmujorin e vitit të kaluar, ka rrugë me shume apo kontrata është me e shtrejt, çka është puna 102 mijë me 65 mijë, a është shtu numri i rrugëve. Te shpenzimet e informimit publik, d.m.th vitin e kaluar vetëm shpenzimet po i përmendi, ka qenë 4900 euro, tash për këtë periudhë është 13745 euro, që është një diferencë ose një krahasim mjaft i madh. Edhe te kjo e përgjithshme, se tash po del që në këtë nëntëmujor janë pagu 347 mijë e 306 euro të vitit të kaluar. Raporti kur po vjen në fillim të vitit, d.m.th kjo vlerë u kanë dikun 180 mijë që janë obligime të vitit të kaluar, tash ky obligim që janë pagu të vitit kaluar 347 mijë e 306 euro, pse nuk po na vjen informata e saktë?

z.Samet Idrizi: Sa i përket kësaj pike, u tha nga parafolësit. Po me duket baza e planifikimit e vitit 2018 ka qenë më e ultë se e vitit 2019. Bukur shumë, edhe për at tash kemi në dallim kur e krahason inkasimin vetanëk të 2019 me 2018. Unë dëshiroj të di si është arrit ky target, si është arrit ky inkasim në dallim kaq të madh në krahasim me vitet tjera, a është meritë e personelit të komunës apo e vetëdijesimit të qytetarëve. Faqe nr. 3, pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësitë buxhetore, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit 20 mijë e 384 euro, janë dikunë 7000 euro me shume se vitin 2018. Nëse ka mundësi me naj sqaru për çka ndodhin këto shpenzime. Kodi 13130, nëse kanë me sjellë një informatë. Kemi rritje të madhe të shpenzimeve të rrymës, 129 mijë euro, krahasuar me 117 mijë me vitin e kaluar. Është mirë të jemi të kujdesshëm me shtrirje të elektrikes. Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, 11 mijë e 45 euro, kanë qenë 6766 euro. Është një rritje 100%. Një sqarim, pse ka ndodh kështu? Pajisje të trafikut, kodi 13508 faqe, 4 shuma 6486 euro, kanë qenë në 2018, tash janë 15711. Çfarë pajisje janë bërë? Pajisje të furnizimit. Kemi edhe një dallim të madh tek çmimi i furnizimit me dru për djegie. Këtë vit i kemi bërë me shtrejt për 20%, nëse ka mundësi procesverbalin e hapjes së tenderit vetëm po du me pa sa operator kanë qenë në tender që kanë ofertu. Kodi 13760, furnizim me lëndë djegëse, dru 128 mijë e 49 euro. Procesverbalin e hapjes së tenderit, mirëmbajtja e ndërtesave është një rritje për 12 mijë euro, mirëmbajtja e autorrugëve lokale edhe këtu kemi rritje, ka qenë 65 mijë, tash 109 mijë. Dreka zyrtare, është mirë nëse janë 27 mijë euro. Unë i kisha nda "Flakadani e Karadakut" me një kod tjetër, që mos me i perzi me dreka e drejtorëve ose kryetari apo stafi i komunës. Shpenzimet e vendimeve të gjykatave 63435 euro. Drejtor, a janë këto krejt të mësimdhënësve apo edhe naj kontekst tjetër që e kemi humb, si është puna. Këtu, faqe 23, prezantimi analitik i investimeve për periudhën Janar-Shtator 2019. Mu më ra në sy këto asfaltimi i rrugëve rurale, përmenden disa fshatra, p.sh.: Buzovik, shtrim të trotuareve, nuk e di vetëm nëse ka fillu naj një. Te planifikimi për lejen mjedisore, është planifiku 6850 euro, nuk ka realizim, është realizu 0%, besoj që ka vend te lejet e planifikimit mjedisor me apliku.

z.Ibrahim Rama, drejtor: Po mundohem me qenë më praktik. Nuk po pritoj me punu asgjë, mirëpo kur po mi shifroni apo kur po me i lexoni regjistrin sipas kodeve, është e pamundshme edhe fizikisht dhe psikikisht këtu për këtu me dhënë detale për brendinë komplet të tyre. Nuk është bërë tri pyetje ose pesë që me pas shënime. Unë të saktë kisha pas dëshirë që mos me i bërë nga 20 pyetje apo 40, po më mirë tri katër pyetje që me mujt me ju përgjigj me, sepse ka në brendinë e saj shume material. Krahasimi i shpenzimeve, asnjëherë nuk ju kam thanë dhe prapë po ju themë nuk është mirë krahasimi nuk mundesh me gjyku me marr një opinion me thanë ti, sepse buxhetet ndryshojnë. Një buxhet është me i vogël këtë vit, vitin tjetër është më i madh. Ndryshojnë kategorinë e shpenzimeve vit pas viti. Unë po ju them që secili këshilltar më bëni pyetjen, unë p.sh.: sot të gjitha pyetjet që i ka pas VV në Komitet për Politikë dhe Financa. Ju kam sjellë sot edhe unë do të mundohem që me u përgjigj kryesish në ato pyetje që i bëni ju tani. Shpërndarja e buxhetit. pyetje nga Mirlinda, e cila konstatoj që nuk është bërë drejt ashtu qyshe unë kam

deklaru në hartimin e buxhetit. Unë po ju garantoj në bazë të kritereve që i ka përcaktuar Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë komisionit ndërministror që e ka bërë shpërndarjen e buxhetit, ndikimi edhe i imi dhe i kryetarit të komisionit, është i pamundur. Ata i kanë kriteret dhe në bazë kritereve i shpërndaj buxhete për komuna, tu fillu prej grandit të arsimit, grandit të shëndetësisë dhe grandit të përgjithshëm, kurse sovraniteti në kërkesën për pjesën e të hyrësve të vjetërve kanë komunat, kurse grandet tjera ndahen nga komisioni ndërqeveritar. Po në at komision janë dhe ministri dhe katër kryetarët e komunave të cilët marrin pjesë gjatë hartimit të buxhetit. Në këtë drejtim të gjitha kërkesat që i kam bërë të gjitha analizat është dalë që janë nda, mirëpo ka disa nënkritere që nuk janë kritere kryesore që i kam shpjeguar para juve, që e bëjnë një dallim të komunave të vogla që nuk duhet buxheti i drejtpërdrejtë ashtu siç është nda edhe për komunat e mëdha. Pat pyetje për shpalljen e bursave. Na zakonisht me buxhet i kemi parapara fondin për bursa. Buxheti është i ndarë se kur fillon procedura e thirrjes publike për dhënien e bursave varet nga Drejtoria e Arsimit. Borxhet e komunës, asnjëherë nuk ka pas diskrepancë ndërmjet të asaj që e kam paraqitur në pasqyrat financiare dhe asaj që është e drejtë që paraqitet para juve. Dhe një pyetje ishte nga Bekim Azizi, pse nuk po përputhet borxhet, pagesat e obligimeve në pasqyra financiare nga viti njëjtë. Këtu përveç që ndryshojnë buxhetin, nuk e përcaktojnë obligimet, sepse në obligime kemi pas ashtu qyshe kam më shumë se 100 e sa mije po janë pjesë të buxhetit që i jeshin obligim për mu pagu me von, d.m.th nuk janë thjesht obligime vetëm të asaj që e kam përcaktuar unë me pasqyra financiare të vitit p.sh.: 2018, po ka edhe shpenzime të tjera që ndërkohë ose janë rritur ose mundet me ndodh shpenzime edhe të 2017. Kurse sa i përket vendimeve gjyqësore, një pjesë e madhe janë për këto kategoritë e pagave, për pension dhe për paga jubilarë dhe sipas ligjit, atyre ju takojnë po sa njëherë Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka da mjet, nuk na ka dhënë buxhet për me i pagu ato, përveç kësaj që e kemi buxhetin e saktë, ku të gjithë punëtorët që shkojnë në pensin i kanë të parapara pagat për vitin 2019, ndërsa prej vitit 2018 e më tej nuk kemi pas as një buxhet, dhe të gjithë na kanë marrë paratë përmes përmblyesit privat. Ishte pyetja tjetër, mirëmbajtja e rrugëve lokale. Këtu kemi shumë, unë muaj me shpallje si informatë, këtë do të sjellin në seancën e radhës. Inkasim i të hyrave ishte një pyetje, çka ka ndikim që kemi pas kësaj rritje me thanë të drejtën edhe përmblyesi privat po edhe pse nuk duhet me qenë kriter që me e proklamim këtë po edhe qytetarët e kanë pa që tash shumë punë po lidhen me kryerjen e obligimit të tatimit në pronë dhe ata janë vetëdijesuar dhe të gjitha këto kanë ndikim që ne me pas një rritje të tillë. Krejt çka është shpenzu, të gjitha shpenzimet janë bërë në kuadër dhe në saktësinë e buxhetit që janë planifikuar. Ne duhet me qenë më të saktë nëse duhet me pas vërejtje në disa parametra. Në momentin që miratohet buxheti, na në qeverinë komunale dhe unë kame për detyrë me e zbatu buxhetin ashtu siç është i planifikuar, pavarësisht paragjykitimit a është planifikuar mirë drektat zyrtare apo udhëtimi zyrtar jashtë vendit.

znj. Mirlinda Sadiku: Drejtor, ky publikim ka dalë më brëmë, d.m.th i referohem koha.net, që është kredibil. Përveç portalit, e ki institutin GAP, i cili prapë ka bërë hulumtim, d.m.th krejt çka kërkoj, se unë vit pas viti i përsëritja të njëjtën çështje. Nuk më dhavë përgjigjen që është rritur shuma e rrugëve 104 mije euro, prej 68 mije sa u kanë në plan të prokurimit ka shkuar 104 mije euro, pse ka një rritje kaq të madhe.

z. Ibrahim Rama Drejtori: Të shpërndarja e buxhetit, plotësisht ju kuptoj juve, përveç kritereve që ndahet buxheti, janë edhe disa nënkritere që duhet mu zbatu në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për arsye të minoriteteve dhe ata kanë burime të caktuara.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit për kontributin e dhënë në këtë pikë të rendit të ditës.

Si pikë të tretë kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për shpalljen në diskutim publik për propozim rregulloren për transparenten në Komunën e Vitisë

z. Mustaf Mehmeti, zyrtar nga Zyra e Informimit: Përsëritje të nderuar të pranishëm! Propozim rregullore që kemi para juve, e ka përgatitur Zyra për Informim publik në kuadër të takimeve që i kemi pas me kolegjiun e transparencës. Kjo draftë rregullore është harmonizuar dhe është shikuar më ligjet në fuqi nga Zyra Ligjore në Viti. Konkretisht me ligjin e ri për qasje në dokumentet publike, udhëzimi i ri administrativ për transparencën si dhe udhëzimi administrativ për standarde minimale të konsultimit publik duke pasur parasysh se propozim rregullore e kemi pranuar para disa ditëve, dua të ju njoftoj se kjo propozim rregullore parashihet të dalë në diskutim publik në

muajin Nëntor, kurse të gjitha komentet të cilat do të grumbullohen nga faza e diskutimit publik dhe të cilat mund të inkorporohen në rregulloren e re, do t'i inkorporojmë. Nëse keni ndonjë pyetje, jam i gatshëm të ju përgjigjem.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. Pasi nuk ka për diskutim, unë po i qes në votim. Nga të gjithë të pranishmit miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës

Si pikë të katërt dhe të pestë të rendit të ditës, kemi, po i qesim të dy pikat, sepse e kanë natyrën e njëjtë

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për ndryshim plotësim të vendimi Nr. 01-410-03-71 të datës 08.02.2018 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim për vendimit Nr.01-410/03-213, të datës 04.03.2019, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Hapim debat rreth këtyre pikave të rendit të ditës. Pasi nuk ka për diskutim, unë po i qes në votim. Nga të gjithë të pranishmit miratohet edhe këto pika të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:00

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Naim Pira



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË
OPŠTINA VITINA/MUNICIPAL OF VITI



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilajmohet Më/Datë 14-11-2019

Nr./ organit Org.broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vlera Vrednos
02-035/02-1144			

RREGULLORE
PËR PALESTRËN SPORTIVE

Viti, 13 nëntor 2019

Në bazë të nenit 58, shkronja h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 50 shkronja l të Statutit të Komunës së Vitisë me Nr.013/491 të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës, në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore propozon këtë:

PROPOZIM RREGULLORE PËR PALESTRËN SPORTIVE

Qëllimi

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës së sporteve në Fshatin Drobesh, kilometri i dytë në Rugën Viti – Gërlicë, për aktivitetet sportive të klubeve të licencuara në federatat gjegjëse, klubeve private, për manifestime të ndryshme të kulturës, tubimeve partiake, revistave si dhe rekreacionit.

Neni 2

1. Klubet dhe subjektet tjera të interesuara për shfrytëzimin e palestrës sportive duhet që së paku 3 ditë para ditës së organizimit të manifestimit, tubimit apo ndeshjes, t'i drejtohen me kërkesë përgjegjësit të Palestrës ose DRKS-së, të cilët janë të obliguar që të kthejnë përgjigje me shkrim brenda 48 orëve.
2. Klubet e regjistruara në DRKS - Sektori i Sportit në Komunën e Vitisë e që janë të licencuara në Federatat përkatëse e që kanë kalendar të rregullt të garave, do të shfrytëzojnë Palestrën në bazë të një orari të rregullt të rregulluar nga përgjegjësi i palestrës në bashkëveprim me udhëheqësit e këtyre klubeve dhe të vërtetuara nga DRKS-së.

Neni 3

1. Të gjitha klubet sportive që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në palestër dhe që janë të regjistruara në DRKS, respektivisht federatat përkatëse e që janë të Komunës së Vitisë, mund ta shfrytëzojnë Palestrën për stërvitje dhe gara në kuadër të sistemit të garave të përcaktuara nga Federatat përkatëse, mbështetur në këto kritere:
 - 1.1 Për stërvitje sportive pa pagesë. (3 stërvitje në javë deri në ora 22.00h);
 - 1.2 Për zhvillimin e ndeshjeve pa bileta - pa pagesë;
 - 1.3 Për zhvillimin e ndeshjeve me bileta, 30% nga mjetet e inkasuar nga shitja e biletave;

- 1.4 Të gjitha shkollat e klubeve publike, që u nënshtrohen rregullave e Rregulloreve të Federatave përkatëse nuk paguajnë 3 (tre) stërvitje në javë, ndërsa Shkollat private paguajnë sipas nenit 3.3 pika (a);
- 1.5 Salla e vogël, fitnes kabineti dhe holet nga klubet e regjistruara shfrytëzohen pa pagesë, po në bazë të një orari të parapërgatitur nga Përgjegjësi i palestrës në bashkëpunim me klubet dhe i vërtetuar nga DRKS.
2. Terrenet e hapura për klubet e regjistruara si dhe shkollat e tyre të sportit shfrytëzohen pa pagesë, (në rast se një gjë e tillë nuk rregullohet ndryshe), ndërsa për aktivitete rekreative të klubeve, shoqatave ose organizatave punuese (të pa regjistruara në DRKS) paguhet shuma prej 10 € për një orë.
3. Palestra e Sporteve (Salla e madhe) mund të shfrytëzohet edhe për manifestime dhe ngjarje të tjera të ndryshme kulturo-sportive duke paguar:
- 3.1 Aktivitete rekreative – sportive pa ndriçim-10€ për një orë dhe aktivitete rekreative sportive me ndriçim - 10 € për një orë.
- 3.2 Aktivitete dhe ngjarje komerciale (për një orë) 180€.
- 3.3 Aktivitete dhe ngjarje jo komerciale (për një orë) 80€.
- 3.4 Aktivitete dhe ngjarje humanitare - pa pagesë
- 3.5 Për Koncerte 30% nga inkasimi i biletave ose pagesa fikse 980 €.

Neni 4

Të gjitha klubet Sportive që nuk janë të Komunës së Vitisë, mund ta shfrytëzojnë palestrën duke paguar shumën fikse prej 80€ për një orë shfrytëzimi.

Neni 5

Transmetimi i ngjarjeve në palestër nga kompanitë televizive, në rast se nuk janë ftuar nga subjekti që organizon aktivitetin, paguajnë tarifë fikse 80€ për transmetim.

Neni 6

Reklamat lëvizëse të sponsorëve të klubeve mund të ekspozohen vetëm gjatë orarit të ndeshjeve të tyre, ndërsa për reklama statike paguhet tarifa ashtu siç parasheh Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale.

Neni 7

1. Prej të gjitha obligimeve financiare lirohen organizimet shtetërore që bënë Komuna për festa shtetërore e kombëtare, qofshin ato me karakter kulturor apo sportiv, por nëse organizatori nuk përfiton nga shitja e biletave.
2. Me kërkesë dhe arsyeshmëri nga pagesa mund të lirohet subjektet, si: shoqatat e dala nga lufta, FSK, Njësi Special Policor, KFOR-i, personat me aftësi të veçanta, por vetë pas aprovimit nga Drejtoria e RKS-së.

Neni 8

Në palestrën e sporteve, ndalohet bartja e armëve dhe mjeteve të tjera eksplozive, pirja e duhanit, alkooli, dhe personat që thyejnë këtë rregull largohen nga palestra nga zyrtarët për siguri.

Neni 9

1. Dëmet e regjistruara gjatë ushtrimeve ose lojërave zyrtare vlerësohen nga një komision prej tre (3) anëtarëve, që themelohet nga Drejtori i DRKS-së dhe ky komision përgatit procesverbal të posaçëm për dëmet e regjistruara.
2. Dëmet e regjistruara nga komisioni i formuar nga Drejtori i RKS, klubin ose subjektin që ka qenë i ngarkuar me përgjegjësi dhe ka shfrytëzuar palestrën në kohen e shkaktimit të atyre dëmeve e ngarkojnë dhe e obligojnë që në afat prej 7 ditësh t'i kompensojnë ato.
3. Në rast të mos kompensimit të dëmeve siç parasheh Neni 9, pika 9.2, përgjegjësi i Palestrës, klubit apo subjektit përgjegjës i ndalohet aktiviteti në palestër, ndërsa DRKS-ja përcjell procedurën në institucionet gjyqësore.

Neni 10

Për shfrytëzimin e palestrës së sporteve, klubet dhe subjektet tjera që kanë orar të rregullt të shfrytëzimit të këtij objekti, nënshkruajnë Kontrata me DRKS-në mbështetur në këtë Rregullore.

Neni 11

DRKS, mund të lëshojë me qira terrenet e hapura Sportive të Palestrës, nëse vlerëson se të hyrat financiare për Komunën janë më të mëdha se sa nga rekreacioni, pas një vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Neni 12

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale të kësaj Rregulloreje bëhen sipas procedurës së njëjtë të nxjerrjes së saj.

Neni 13

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërsa Kryetari i Komunës e përcjell implementimin e saj.

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Viti.

Viti, 13 nëntor 2019

Propozuesi:


Kryetari i Komunës:

Sokol HALITI





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencën në Komuna, neni 6 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen në diskutim publik të Draft Strategjisë Komunale kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2019 - 2023

Neni 1

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të shpallë në diskutim publik Draft Strategjisë Komunale kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2019 - 2023

Neni 2

Propozimi në diskutim publik i Draft Strategjisë Komunale kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2019 - 2023 do të jepet në diskutim publik deri me: 31.12.2019. Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik, gjithashtu në formën të shkruar mundë të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së dëgjimit publik ne zyrën për barazi gjinore në Komunën e Vitisë ndërtesa e komunës si dhe në forme elektronike munde të dërgohen ne emalin adresën ibadete.hyseni@rks-gov.net, dokumenti gjendet në fep faqen e komunës së Vitisë, kk.rks-gov.net/viti.

Neni 3

Debati publik do të mbahet me datën: 06.01.2020 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për Draft Strategjisë Komunale kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2019 - 2023

Neni 6

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

PROPOZUES: KRYETARI I KOMUNËS

Sokol Haliti





KOMUNA E VITISË

DRAFT STRATEGJIA KOMUNALE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE 2019-2023

Viti, 2019

Lajmrimi i rasteve të dhunës në familje

Kontakt:



Tel: 0280/381199 – Policia e Kosovës / Viti
0280/381660 – Qendra për Punë Sociale / Viti
112 – Thirrjet emergjente

PËRMBAJTJA

**FALENDERIME
SHKURTIME**

KAPITULLI 1: HYRJE PËRMBLEDHËSE

**KAPITULLI 2: QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE
STRATEGJISË**

**KAPITULLI 3: ANALIZA E SITUATËS DHE PROBLEMATIKA E
DHUNËS NË FAMILJE**

**KAPITULLI 4: KOHËZGJATJA E ZBATIMIT TË STRATEGJISË DHE
INSTITUCIONET E PËRFSHIRA**

KAPITULLI 5: AKTIVITETET NË ZBATIM TË STRATEGJISË

**KAPITULLI 6: PLANI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT TË
PROGRESIT NË ZBATIM**

SHTOJCA 1: PLANI I VEPRIMIT

FALENDERIME

Draft Strategjia Komunale kundër Dhunës në Familje është një prej dokumenteve të rëndësishme të Komunës së Vitisë, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti të rëndësishëm për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë. Grupi i punës për hartimin e Strategjisë, i përbërë nga përfaqësues të ZBGJ, QKMF, QPS, OJQ"EuLoc", Grupi Grave, Mediat Lokale, Policia e Kosovës, falenderon veçanërisht institucionet komunale për kontributin që ka treguar se vlerëson me prioritet masat për parandalimin e dhunës në familje: Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS), Drejtorinë e Administratës e dikasterë të tjerë.

SHKURTIME

PK	Policia e Kosovës - Viti
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
QKMF	Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
ZBGJ	Zyrtarja për Barazi Gjinore
ZKK	Zyra Komunale për Komunitete
ZKP	Zyra Komunale për punësim – Viti
GG	Grupi i Grave

KAPITULLI I

HYRJE PËRMBLEDHËSE

Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Komunale dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje për Komunën e Vitisë, mundëson koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse komunale dhe të organizatave joqeveritare. Qëllimi i vetëm i këtyre përpjekjeve të përbashkëta është të parandalojë dhe luftojë Dhunën në Familje si dhe të ndihmojë zhvillimin adekuat dhe mirëqenien e të gjithë shoqërisë sonë.

Parandalimi dhe luftimi i Dhunës në Familje kërkon angazhim të strukturave të ndryshme publike dhe private, për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet të ndryshme si ato të arsimit, shëndetit, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve, etj. Tërë këto çështje përmbajnë problematika që duhen zgjidhur përmes proceseve të zhvillimit të shoqërisë në tërësi. Strukturat vendimmarrëse, së bashku me organizatat joqeveritare, kanë detyrime në zbatim të kësaj strategjie, të cilat rrjedhin nga funksionet specifike dhe roli që luajnë në shoqëri.

Ky dokument synon të japë ndihmesën e saj në arritjen e standardeve më të larta në trajtimin e çështjeve të Dhunës në Familje, si pjesë e përpjekjeve të Komunës së Vitisë. Kjo strategji i referohet implementimit si dhe zbatimit të kuadrit ligjor kundër dhunës në familje në tërësi, i cili ndër të tjera thekson:

1. Të hartohen politika në nivel lokal për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje.
2. Mbështetja financiare e strehimoreve regjionale që mbështesin nëna me fëmijë, në proporcion me numrin e rasteve nga Komuna e Vitisë të strehuara si viktima të dhunës në familje

Hartimi i kësaj strategjie është kryer përmes një procesi të gjatë pjesëmarrës, nën drejtimin e Komunës, drejtuesit më të lartë dhe stafet përgjegjëse të drejtorive të ndryshme përfshirë në proces, së bashku me të gjitha institucionet e tjera në nivel komunal. Gjatë muajit Nëntor janë organizuar dhe do të organizohen një sërë takimesh të gjera për njohjen e situatës, hartimin e drejtimeve strategjike dhe planifikimin e aktiviteteve specifike sipas termave kohorë të kësaj strategjie.

KAPITULLI II

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË STRATEGJISË KOMUNALE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Krahas vështirësive ekonomike, shoqëria jonë po ballafaqohet edhe me një sërë problemesh tjera të papunësisë, të lëvizjeve demografike, të koncepteve të ndryshme mbi vlerat dhe virtytet njerëzore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje dhe pabarazisë gjinore. Prandaj, Komuna jonë ka nevojë që të hartojmë këtë strategji me anë të së cilës synojmë një shoqëri ku secili respektohet si duhet dhe të jetë në gjendje të realizojë potencialin që ka, pa dhunë dhe diskriminim.

Strategjia komunale kundër Dhunës në Familje për Komunën e Vitisë, synon të:

- ☐ Të punojë në parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;
- ☐ Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevant;
- ☐ Të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;
- ☐ Të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

Fushat e veprimit dhe objektivat strategjike të këtij dokumenti janë:

Fushat e Veprimit A.

ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Deri në vitin 2023, strategjia komunale synon që të kontribujë në ndryshimin e qasjes në familje dhe shoqërisë për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje

Fushat e Veprimit B.

ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Deri në vitin 2023, strategjia komunale synon një komunitet të mirëinformuar, edukuar në çështjet e dhunës në familje, me profesionistë, të aftë dhe të përgatitur për trajnimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në përgjithësi si dhe të kryersve të veprës penale (kryerësit të dhunës)

Fushat e Veprimit C.

FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Deri në vitin 2023, strategjia komunale synon në parandalimin, mbrojtjen dhe rintegrimin përmes mbështetjes ekonomike dhe dhënien e mundësive për mirëqenien e të mbijetuarave

të Dhunës në Familje dhe të familjeve të tyre si dhe kryerësit të veprës penale (kryerësit të dhunës)

Fushat e Veprimit D.

FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Deri në vitin 2023, strategjia komunale synon të ketë një koordinim më të mirë për parandalimin, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe riintegrimin e tyre dhe të familjeve në jëtë ekonomike dhe sociale të komunës.

Çdo objektiv strategjik është zbërthyer më tej në disa objektiva specifike, për të cilat është zhvilluar një plan veprimi i detajuar me aktivitete, institucionet përgjegjëse dhe partnere si dhe vlerësime të tjera që lidhen me afatet kohore të zbatimit, kostot dhe planin e monitorimit.

KAPITULLI III

ANALIZA E SITUATËS DHE PROBLEMATIKA E DHUNËS NË FAMILJE

Dhuna në Familje nuk është një dukuri e re për qytetarët e komunës sonë, por edhe shoqërinë kosovare në përgjithësi. E shprehur në forma dhe intensitete të ndryshme ajo është trashëguar prej së shkuarës, por në ditët e sotme vërehen edhe shumë tipare të reja të shprehjes së saj. Analiza e shkurtër e situatës në Komunën e Vitisë, ka ndihmuar të qartësohet lista e problemeve dhe shkaqeve që i shkaktojnë ato. Shkaqet që çojnë në rritjen e shkallës së Dhunës në Familje janë të shumta, ndërmjet të cilave përmendim:

Pabarazitë gjinore: Në Kosovë, roli i femrave në proceset e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik është shumë i rëndësishëm, ndonëse ende në ditët e sotme ndeshemi me pabarazi gjinore të dukshme apo të fshehura. Pozita e pabarabartë gjinore ndikohet nga shkalla e ulët e punësimit të grave, vështirësitë që kanë në qasje të shërbimeve shëndetësore, niveli i ulët i integritit të grave në ekonomi dhe numri i vogël i grave në pozitat udhëheqëse në administratën publike.

Në Kosovë është krijuar një bazë e mirë ligjore sa i përket çështjes së barazisë gjinore dhe janë bërë hapa të dukshme në avancimin e pozitës së grave, ku Komuna e Vitisë, krahas viteve të mëhershme, ka shënuar progres të dukshëm në avancimin e gruas. Të dhënat paraqesin një përfshirje më të madhe të grave në politikë, në arsim, e sektorë të tjerë. Megjithatë, ende nuk është arritur përfaqësimi i kënaqshëm gjinor, i paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore, në të cilin përcaktohet se pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve, në institucione apo në nivel të pushtetit, është 50% me 50%. Duke pasur parasysh trendet e varfërisë, shkallës së papunësisë, për një pjesë të popullsisë në Komunën e Vitisë, femra mbetet në pozitë më të pafavorshme krahasuar me meshkujt si në lëmin e punësimit, nivelit të varfërisë, arsimit, si dhe pjesëmarrjen aktive në sferën publike dhe private.

Pabarazitë gjinore në gjendjen ekonomike: Në Komunën e Vitisë ashtu si në tërë vendin, gjendja e vështirë ekonomike rëndon më shumë mbi femrat, të cilat kanë numrin më të madh të papunësuarve dhe nivelin më të ulët arsimor. Për vitin 2019, janë të rexhistruara 470 familje me 1600 anëtarë në skemën e ndihmës sociale, prej tyre 14 familje nga komuniteti pakicë me 51 anëtarë. Nga komuniteti serb janë 6 familje me 21 anëtarë, nga ai ashkalinj 4 familje me 17 anëtarë, nga komuniteti kroat 2 familje me 3 anëtarë si dhe nga ai boshnjak janë 2 familje me 10 anëtarë.

Probleme sociale të lidhura me dhunën në familje: Martesat e hershme janë një ndër dukuritë evidente në komunën e Vitisë që prek vajzat dhe djemtë, ndonëse vajzat janë në numër më të madh dhe përballen me pasoja më të shumta. Martesat e hershme privojnë të rinjtë, e sidomos vajzat nga arsimimi dhe zhvillimi i perspektivave afatgjata. Vajzat lindin fëmijë në moshën e tyre më të hershme, mbeten të izoluara nga shoqet, shokët dhe familja e tyre. Gratë e reja nuk mund të dalin vetëm, pa pajtimin e burrit apo anëtarëve tjerë të familjes dhe nuk fitojnë të ardhura, ndaj mbeten të varura ekonomikisht dhe nuk janë vendimmarrëse në ekonominë familjare. Për këto arsye, këto gra të reja janë më të prekura nga dhuna në familje. Sipas disa të dhënave, numri i rasteve të paraqitura në Qendrën për Punë Sociale (QPS) - Viti për dhënien e pëlqimit për martesë të hershme ndryshon:

viti 2017: Nuk kemi patur raste të martesës së parakoheshme

viti 2018: Nuk kemi patur raste të martesës së parakoheshme

viti 2019: 2 raste të martesës së parakoheshme

Numri i rasteve është dukshëm më i madh, por për shumë prej tyre nuk ka raportime.

Dhuna në Familje sjell shumë pasoja në komunitet, të cilat kanë një numër të madh efektesh të padëshiruara:

Kriza familjare: Avancimi i rolit të femrës në shoqëri dhe pozita e saj në familje ka ndryshuar në kuptimin e pavarësisht më të madh të saj, marrjes së iniciativave, edukimit dhe arsimimit, fakte të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e roleve në familje dhe shoqëri. Kriza familjare në periudhën e pas luftës në Kosovë ka shkaqe të ndryshme: lëvizja e popullatës nga fshatrat në qytete, kalimi nga familjet e zgjeruara dhe të mëdha në familje më të vogla. Të tilla ndryshime shihen si faktorë mbrojtës (kur shmanget ndikimi patriarkal prej brezave më të vjetër), por edhe faktorë rreziku njëherësh, si pamundësia e mbrojtjes në rastet e dhunës në familje të nxitura nga papunësia, konfliktet dhe mentalitetit mes gjeneratave, etj.

RRITJA E DIVORCEVE NË SHOQËRI: Numri i divorceve ndryshon nga viti në vit. Në vitin 2017 ka pasur 45 kërkesa për divorc, në vitin 2018 kanë qenë 65 kërkesa, ndërsa në vitin 2019 janë 54 kërkesa. Sa i përket rritjes së numrit të divorceve nga viti në vit, nuk kemi arritur të nxjerrim ndonjë përfundim.

Nga tregues statistikor, numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në QPS për vitin 2017 janë 8 ndaj të cilave është ushtruar dhunë në familje, prej ketyre rasteve 2 janë vendosur në strehimore për mbrojtjen e viktimave. Ndërsa në policia po në vitin 2017 janë trajtuar 21 raste. Në vitin 2018 janë evidentuar 36 raste të dhunës në familje (raste këto të trajtuara nga QPS-ja), ndërsa nga policia 48 raste. Këto raste 2 ishin të vendosura në strehimore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Ndërsa në vitin 2019 është rritur

numri. Nga QPS-ja janë të trajtuara 51 viktimat edhe pse ende nuk ka përfunduar viti kalendarik nga keto raste 1 ka qenë në strehimore. Në vitin 2017, strehimorja e Gjilanit ka mbështetur 2 raste të dhunës në familje, prej të cilave 1 rast është me 3 fëmijë, ndërsa për vitin 2018 në strehimoren e Gjilanit “ Liria” janë të strehuara 2 raste. Meqenëse në disa raste është arritur zgjidhje dhe tejkalim i problemeve falë ndërmjetësimit të Qendrës për Punë Sociale, ku viktimat e dhunës janë rikthyer në shtëpitë e tyre, disa raste tjera kanë mbetur ende pa zgjidhje, pasi që qëndrimi në strehimoren regjionale “ Liria” është i përkohshëm, deri në 6 muaj, por në strehimoren “ Liria” në Gjilan, ndodh që për ndonjë rast më specifik strehimi ti vazhdohet deri në 1 vit por, varësisht nga rasti ndodh që edhe deri në dy vite. Viktimat e dhunës në familje, pas qëndrimit gjashtëmuor transferohen në strehimoret tjera (në regjionet tjera të Republikës së Kosovës), ku në çdo strehimore qëndrimi i tyre zgjat jo më tepër se gjashtë muaj. Mandej këto viktimat të dhunës, nuk kanë zgjidhje tjetër, ose të kthehen në shtëpinë e gjinisë së tyre, ku shpeshherë ndodh që mos ti pranojnë edhe ato, ose të kthehen sërish tek kryerësi i cili ka ushtruar dhunë ndaj tyre, pasi që nuk mund të bëjnë zgjidhje tjetër.

Krahas numrit të raportuar, rastet e dhunës në familje mbeten më tepër raste të izoluara dhe shumë pak të raportuara. Nga ndryshimet e statistikave nga viti në vit, vërehet se ka një rritje të raportimit të rasteve të dhunës në familje në institucionet gjegjëse, që na bënë të kuptojmë se është rritur dukshëm vetëdijësimi qytetar për të raportuar dhunën krahasuar me periudhat e mëhershme, por njëkohësisht është rritur edhe besimi qytetar në institucionet që luftojnë këtë fenomen.

Viktimat të dhunës në familje, marrë për bazë statistikën e vitit 2017, 2018 dhe 2019, kryesisht janë nga gjinia femërore.

Frika dhe ndërgjegjësimi ulët për çështjet e dhunës në familje: Mos raportimi i dhunës në familje nga viktimat është ndër fenomenet më të shpeshta, pasi konsiderohet turp dhe një çështje që nuk duhet të dalë jashtë mureve të shtëpisë.

Mospranimi i dhunës seksuale: Për shkak të stigmës dhe ndëshkimit vërehet mos raportim i dhunës nga ana e viktimave dhe për këtë dhuna seksuale rezulton më pak e raportuar ose nuk ekziston fare në krahasim me dhunën fizike.

Probleme lidhur me trashëgiminë: Sa i përket procedurave të shqyrtimit të trashëgimisë, shumë herë ndodh që gruaja nuk njoftohet fare ose përjashtohet nga diskutimi për masën trashëgimore, qoftë në pozitën e bashkëshortes, nënës apo motrës dhe në këtë mënyrë diskriminohet. Veç kësaj, organi kompetent komunal për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve ka për detyrë që në aktvdekje të shënojë emrat e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj dhe asesi të mos i diskriminojë femrat.

KAPITULLI 4: KOHËZGJATJA E ZBATIMIT TË STRATEGJISË DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA

Shtrirja kohore e strategjisë

Strategjia Komunale kundër Dhunës në Familje është paraparë si një strategji 5 vjeçare që do të zbatohet në periudhën 2019-2023.

Institucionet zbatuese dhe partnere

Komuna Viti: Institucioni kryesor zbatues për strategjinë është Komuna e Vitisë me dikasterët e saj (ZBGJ, QPS, QKMF, DKA), Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjykatat

Ndër institucionet e tjera të përfshira në zbatimin e elementeve të caktuara të kësaj strategjie janë:

Ekipa Vepruese për Siguri në Bashkësi – EVSB, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, OJQ-të

Zyra për Punësim: Në koordinim me Qendrën për Punë Sociale, regjistron dhe evidenton personat, të cilët lajmërohen në zyrë, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje. Këtyre personave në cilësi të punëkërkesve, ju ofrohet: këshillim profesional, informim mbi mundësitë e punësimit, përgatitje dhe ndërmjetësim në punësim, informim për aftësim dhe riaftësim profesional me qëllim përgatitjen për nevojat e tregut të punës.

Mbrojtësi i viktimave i cili bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera që ofrojnë ndihmë për viktimat e Dhunës në Familje, dhe lloje të tjera të dhunës apo trafikimit me qenieve njerëzore, etj si Policinë, QPS, Prokurorinë, Gjykatën, QKMF, strehimoren, etj. Ndër detyrat e tij është të informojë viktimën për të drejtat ligjore, të parapara sipas ligjeve në fuqi për dhunën në familje, të parapërgatitë viktimën për seancat gjyqësore, e shoqëron gjatë seancave si në Prokurori dhe Gjykatë, etj.

Zyra për Ndihmë Juridike falas

Kjo zyrë është regjionale, e cila gjendet në Gjilan dhe ofron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës.

KAPITULLI 5:

AKTIVITETET NË ZBATIM TË STRATEGJISË

(Plani i Veprimit të kësaj Strategjie gjendet i bashkëlidhur në Shtojcën 1)

Arritja e objektivave strategjike të kësaj Strategjie është paraparë të kryhet përmes zbërthimit të tyre në disa objektiva specifike me aktivitetet përkatëse.

Aktivitetet në planin e veprimit janë renditur sipas tre shtyllave bazë të përcaktuara edhe në Planin e Veprimit të Kosovës: Parandalim, Mbrojtje dhe Riintegrim. Për arritjen e objektivave të kësaj Strategjie, aktivitetet janë specifikuar edhe sipas prioritetit për zbatim:

Afat Shkurtra: aktivitete të rëndësishme të lartë që duhet të zbatohen brenda një afati kohor të shkurtër 6 muaj – 1 vit. Të tilla mund të jenë ngritja dhe forcimi institucional për adresimin e Dhunës në Familje, çështje që lidhen me forcimin e mbrojtjes, etj

Afat Mesme: aktivitete të rëndësishme që duhet zbatohen brenda periudhës kohore 1-2 vjeçare. Ndër aktivitete të tilla mund të jenë edhe ato që kërkojnë fonde, të cilat duhet të sigurohen nga institucionet gjegjëse për implementimin e kësaj strategjie.

Afat Gjata: janë renditur të gjitha aktivitetet të cilat synojnë konsolidimin dhe qëndrueshmërinë afat gjatë të mbështetjes që u jepet të mbijetuarave prej Dhunës në Familje, shërbimeve cilësore, etj

Aktivite në vijimësi: janë aktivitete, të cilat do të kryhen prej institucioneve zbatuese dhe atyre partnere në vijimësi, si pjesë e punës së tyre. Ndër to mund të përmendim aktivitetet që kanë të bëjnë me parandalimin, informimin dhe vetëdijësimin e komunitetit.

Objektivat specifike dhe disa prej aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit renditen si më poshtë:

FUSHA E VEPRIMIT –

A. ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Objektiv Specifik A.1.

Eliminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje:

Aktivitete:

- Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese mediatike për publikun e gjerë në komunën e Vitisë
- Trajnimet për barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të institucioneve komunale

Objektiv Specifik A.2.

Ngritja e vetëdijësimin të grave dhe të rinjve, institucioneve dhe OJQ-ve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazive gjinore.

Aktivitete:

- Fushata (drama me temë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje, ligjërata, ese, dhe piktura me të rinjtë dhe grupe të ndryshme të interesit)
- Takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në Dhunën në Familje. Gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje
- Debate të hapura dhe emisione televizive me tematika rreth Dhunës në Familje, me përfaqësues të institucioneve dhe të OJQ-ve

Objektiv Specifik A.3.

Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse

Aktivitete:

- Ndarja e përvojave të suksesshme të grave në pozita udhëheqëse gjatë takimeve me gratë dhe komunitetin

FUSHA E VEPRIMIT –

B. ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Objektiv Specifik B.1:

Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të Arsimit të Mesëm të Ulët dhe Arsimit të Mesëm të Lartë për çështjet e Dhunës në Familje dhe LMDHF

Aktivitete:

- Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit koordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj
- Informimi i prindërve për mekanizmin koordinues nëpërmjet zyrtarëve të arsimit
- Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, fletëpalosje)

Objektiv Specifik B.2:

Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve të edukatës qytetare lidhur me Dhunën në Familje dhe trajtimin e saj

Aktivitete:

- Organizimi i trajnimeve të mësimdhënësve të edukatës qytetare për çështje të Dhunës në Familje
- Organizimi i shkëmbimit të përvojave përmes vizitave studimore të specialistëve të kësaj fushe

Objektiv Specifik B.3:

Ulja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e mesme të ulët dhe të lartë si rezultat i Dhunës në Familje, në zonat rurale apo komunitete të ndryshme

Aktivitete:

- Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve

- Vetëdijesimi nëpërmjet liderëve të komuniteteve dhe ndërmjetësuesve përmes takimeve dhe punës me familje të veçanta që shfaqin probleme të Dhunës në Familje
- Aplikimi i masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës

**FUSHA E VEPRIMIT –
C: FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE**

Objektiv Specifik C.1:

Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim

Aktivitete:

- Regjistrimi, evidentimi dhe orientimi i viktimave të Dhunës në Familje
- Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës
- Hartimi i kuadrit nënligjor, përmes nxjerrjes së një vendimi në nivel komunal, për lirim nga taksat komunale për rastet e dhunës në familje në rastet e hapjes së një biznesi të ri

Objektiv Specifik C.2:

Mbështetje socio-ekonomike të mbijetuarve të Dhunës në Familje

Aktivitete:

- Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes
- Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të veçantë prej komunës
- Ndarja e subvencioneve për familjet në zonën rurale përmes ndarjes së farërave pranverore dhe vjeshtore
- Përkrahje e strehimores regjionale për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarve të Dhunës në Familje si dhe bashkëpunimi me mekanizmat që merren me çështjet e dhunës në familje

Objektiv Specifik C.3:

Zgjidhje e strehimit për rastet e të mbijetuarve të Dhunës në Familje

Aktivitete:

- Ofrimin e mbështetjes ekonomike përmes pagesës së qirasë për rastet e pazgjidhura

FUSHA E VEPRIMIT –

D: FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Objektiv Specifik D.1:

Fuqizimi i Mekanizmit koordinues në nivel të komunës

Aktivitete:

- Takime me strukturat udhëheqëse të komunës për qartësimin e roleve dhe përgjegjësi
- Takime periodike të Mekanizmit Koordinues për shkëmbim informacioni dhe koordinim aktiviteteve.

Objektiv Specifik D.2:

Kritja e vetëdijes për identifikimin sa më të hershëm të situatave të rrezikut për Dhunën në Familje prej secilit institucion dhe planifikimin e masave parandaluese

Aktivitete:

- Identifikimi i rasteve të dhunës në Familje
- Regjistrimi në databazë dhe vlerësimi i nevojave të mbijetuarve të Dhunës në Familje.

KAPITULLI 6

PLANI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT TË PROGRESIT NË ZBATIM

Për monitorim dhe zbatimin të kësaj strategjie obligohet Komuna e Vitisë dhe dikasterët tjerë të përmendur në këtë dokument..

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të saj si dhe ato partnere duhet të informojnë në mënyrë të rregullt Zyrën e Kryetarit - me anë të të dhënave mbi arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve të përcaktuara.

Të paktën një herë në vit, Kryetari i Komunës raporton në Kuvendin e Komunës mbi progresin në zbatimin e strategjisë sipas treguesve të përcaktuar për çdo drejtim strategjik.

SHTOJCA 1:

PLANI I VEPRIMIT



Komuna e Vitisë

PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE (2019 – 2023)

REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VITISË - OPSTINIA VITINA

Strukturë - Projekto Mëdha: 15.11.2019

Nr. i organit: 02-036/02-1151

Organi: Shërbimi i Mbrojtjes

Vlera: 1151

FUSHA E VEPRIMIT – A. ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE				
Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon të ndryshojë qasjen në familje dhe shqëritë për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje				
Drejtimi strategjik	Aktivitetet	Koha e zbatimit	Indikator i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
A.1. Eliminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje	1.1 Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese mediale për publikun e gjerë në komunën e Vitisë	P+M+R ASH+AM	Prej rreth 46786 banorëve, rreth 35% e tyre kanë marrë mesazhin dhe janë bërë pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuere	Institucioni Përgjegjës: QPS, Policia, EVSB
	1.2 Trajnimet për Barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të institucioneve vendore	P+M+R ASH		Institucione Partner: Komuna OJQ-te Media lokale
A.2. Ngritja e vetëdijësimit të grave dhe të rinjve, institucioneve dhe	2.1 Fushata (drama, me temë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje, ligjërata, ese, dhe piktura) me të rinjtë	P Aktivitet në vijimësi	Rritja e përqindjes së grave dhe vajzave të ndërgjegjësuar	Institucioni Përgjegjës: OJQ-te

bizneseve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazisë gjinore	2.2 Takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në DHF. Gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje	P	nga 40% në 55%	Institucione Partnere: Komuna Bizneset Donatore
	2.3 Debate të hapura dhe emisione televizive me tematika rreth DHF, me përfaqësues të institucioneve dhe të bizneseve.	P+M+R Aktivitet në vijimësi		
	3.1 Ndarja e përvojave të suksesshme të modeleve në takime me gratë dhe komunitetin	P AGJ		
A.3. Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse			Rritja e përqindjes së grave pjesëmarrëse aktive në takime	Institucionet Përgjegjëse: OJQ lokale
			Rritja e përqindjes së grave në pozicionet vendimmarrëse nga 30% në 45%	Institucione Partner: MK, grupi i grave asambleiste

FUSHA E VEPRIMIT – B. ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon një komunitet të mirëinformuar, edukuar në çështjet e dhunës në familje, me profesionistë të përgatitur për të parandaluar, njohur dhe kualifikuar për trajtimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në tërësi si dhe të kryerësve të veprave penale

Drejtimi strategjik	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit	Indikator i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
B. 1 Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të AMU dhe AML për çështjet e DHF dhe LMDF	1.1 Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit kordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj	P+M+R Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2023, rreth 50% e nxënësve dhe prindërve janë të ndërgjegjësuar për LMDF dhe DHF	Institucioni Përgjegjës: Mekanizmi kordinues Institucione Partner: Drejtorja e arsimit, OJQ të
	1.2 Informimi i prindërve për mekanizmin kordinues nëpërmjet zyrtarëve të arsimit	P Aktivitet në vijimësi		

	1.3 Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, postera)	P ASH + AM		
B.2 Ngritja profesionale e mësimeve të edukatës qytetare lidhur me DHF dhe trajtimin e saj	2.1 Organizimi i trajnimeve të mësimeve të edukatës qytetare për cështje të DHF	P Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2023, 25% e orëve të edukatës qytetare do të kalojnë në tematika të DHF	Institucioni Përgjegjës: Drejtorja e Arsimit Institucione Partner: OJQ
	2.2 Ngritja e qendrave didaktike të integruara me programe të vecanta për trajnimin mbi cështje të DHF	P AM		
	2.3 Organizimi i vizitave studimore për shkëmbimin e përvojave me vendet e rajonit	P AM		

B.3 Ujia e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e ulët dhe të lartë si rezultat i DHF, në zonat rurale apo komunitete të ndryshme	3.1 Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve të familjeve ku ushtrohet dhunë	P+M+R ASH	Deri në vitin 2023, ulët numri i nxënësve që braktisin shkollën prej DHF	Institucioni Përgjegjës: Drejtoria e Arsimit Institucione Partner: Mekanizmi kordinues
	3.2 Vetëdijësimi nëpërmjet lidërëve të komuniteteve dhe ndërmjetësuesve përmes takimeve dhe punës me familje të vecanta që shfaqin probleme të DHF	P+M+R ASH+AM		
	3.3 Monitorimi i aplikimit të masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës	P+M ASH+AM		

FUSHA E VEPRIMIT – C. FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon në parandalimin, mbrojtjen dhe rintegrimin përmes mbështetjes ekonomike dhe dhënien e mundësive për mirëqënien e të mbijetuarave të DHF dhe të familjeve të tyre si dhe kryerësve të veprës penale

Drejtimi strategjik	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit	Indikator i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
C.1 Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim	1.1 Rregjistrimi, evidencimi dhe orientimi i viktimave të DHF pranë komunës	M+R AM	Brenda 5 viteve sistemi i regjistrimit dhe orientimit bëhet funksional sipas standardeve kombëtare në përpunim	Institucioni Përgjegjës: Komuna
	1.2 Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës	M+R Aktivitetet në vijimësi		Institucione Partner:
	1.3 Hartimi dhe aprovimi normave rregullative, përmes krijimit të politikave, për lirin nga taksat komunale në rastet e hapjes së një biznesi të ri	M+R ASH		Sipas përcaktimit të standartit kombëtar

2. Mbështetje socio ekonomike të mbijetuarave të DHF	2.1 Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes	M+R Aktivitet në vijimësi	25% e viktimave përfitojnë shërbimet në këtë kategori	Institucioni Përgjegjës: Përgjegjës: komuna
	2.2 Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të vecantë prej komunës	M+R AM		
	2.3 Ndarja e subvencioneve për familjet në zonën rurale përmes ndajës së farërave pranverore dhe vjeshtore	P+M+R AM		
	2.4 Përkrahje e strehimores "LIRIA" për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarave të DHF	M+R Aktivitet në vijimësi		
3. Zgjidhje afatmesme e strehimit për rastet e të mbijetuarave të DHF	3.1 Pagesa e qirasë për vendstrehimin e viktimave të dhunës në familje	M+R Aktivitet në vijimësi		Institucioni Përgjegjës: Komuna
	3.2 Ofrimin e mbështetjes ekonomike përmes pagesës së qerasë për rastet e pazgjedhura	M+R AM		
				Institucione Partner: Donatorë

FUSHA E VEPRIMIT – D. FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NË INSTITUCIONALE

Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon të ketë institucione funksionale dhe të mirëkordinuara për parandalimin, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe riintegrimin e tyre dhe të familjeve në jetën ekonomike dhe sociale të komunës.

Drejtimi strategjik	Aktivitetet	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit	Indikator i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
D.1 Institucionalizimi i Mekanizmit kordinues në nivel të komunës	1.1 Takime me strukturat udhëheqëse të komunës për qartësimin e roleve dhe përgjegjësi	P+M+R ASH	Të paktën 4 takime të organizuara cdo vit	Institucioni Përgjegjës: MK
	1.2 Takime periodike të Mekanizmit Kordinues për shkëmbim informacioni dhe kordinimin e veprimeve konkrete..	P+M+R Aktivitet në vijimësi		
D.2 Rritja e vetëdijes për identifikimin sa më të hershëm të situatave të rrezikut për DHF prej secilit institucion dhe planifikimin e	2.1 Hartimi i formularëve të posacëm për raportimin e rasteve të rrezikut për DHF dhe rasteve të identifikuar	P+M ASH	Deri në fund të vitit 2023 institucionet e komunës do të kenë të ngritur sistemin e identifikimit , regjistrimit dhe	Institucioni Përgjegjës: MK Institucione

masave parandaluese					
2.3 Identifikimi i shkaqeve që paraprijnë rastet e DHF permes analizimit me anë të anketimeve në shkollë, institucione shëndetësore, diskutimeve mediatike me specialistë	P+M AGJ		Vlerësimi të rasteve të DHF.		Partner: OJQ, shkollë
			Të dhënat për shkaqet dhe situatën janë të mbledhura në bazë periodike		
2.4 Planifikim i punës dhe mbështetjeje institucionale për grupet më vulnerabël për DHF (përfshirë pleqtë, të rinjtë dhe njerëzit me nevoja të vecanta)	P+M+R AGJ		Numri i raste të ndihmuara/rehabilitu ara		



Komuna e Vitisë

REPUBLIKA E KOSOVES - DEPARTAMENTI I
KOMUNA E VITISE - QJ 07/194 VITE J
15.11.2019
Niveli i punës: 02-036/02-1161
Niveli i punës: 02-036/02-1161
Niveli i punës: 02-036/02-1161
Niveli i punës: 02-036/02-1161

PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE (2019 – 2023)

FUSHA E VEPRIMIT – A. ELIMINIMI I PABARAZIVË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE
Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon të ndryshojë qasjen në familje dhe shoqëri për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje

Drejtimi strategjik	Aktivitetet	Koha e zbatimit	Indikator i suksesit	Institucion et përgjegjës e për zbatim
A.1. Eliminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje	1.1 Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese mediatike për publikun e gjerë në komunën e Vitisë	P+M+R ASH+AM	Prej rreth 46786 banorëve, rreth 35% e tyre kanë marrë mesazhin dhe janë bërë pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuese	Institucioni Përgjegjës: QPS, Policia, EVS
	1.2 Trajnimet për Barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të institucioneve vendore	P+M+R ASH		Institucione Partnerë: Komuna OJQ-te Media lokale
	2.1 Fushata (drama, me temë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje, ligjërata, ese, dhe piktura) me të rinjtë	P Aktivitet në vijimësi	Rritja e përqindjes së grave dhe vajzave të ndërgjegjësuar	Institucioni Përgjegjës: OJQ-te

bizneseve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazisë gjinore	2.2 Takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në DHF. Gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje	P	nga 40% në 55%	Institucione Partnerë: Komuna Bizneset Donatorë
	2.3 Debate të hapura dhe emisione televizive me tematika rreth DHF, me përfaqësues të institucioneve dhe të bizneseve.	P+M+R Aktivitet në vijimësi		
	3.1 Ndajja e përvojave të suksesshme të modeleve në takime me gratë dhe komunitetin	P AGJ		
A.3. Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse			Rritja e përqindjes së grave pjesëmarrëse aktive në takime	Institucioni Përgjegjës: OJQ lokale
			Rritja e përqindjes së grave në pozicionet vendimmarrëse nga 30% në 45%	Institucione Partner: MK, grupi i grave asambleiste

FUSHA E VEPRIMIT – B. ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon një komunitet të mirëinformuar , edukuar në çështjet e dhunës në familje , me profesionistë të përgatitur për të parandaluar, njohur dhe kualifikuar për trajtimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në tërësi si dhe të kryerësve të veprave penale

Drejtimi strategjik	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit	Indikator i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
B.1 Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të AMU dhe AML për çështjet e DHF dhe LMDF	1.1 Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit kordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj	P+M+R Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2023, rreth 50% e nxënësve dhe prindërve janë të ndërgjegjësuar për LMDF dhe DHF	Institucioni Përgjegjës: Mekanizmi kordinues Institucione Partner: Drejtoria e arsimit, OJQ të
	1.2 Informimi i prindërve për mekanizmin kordinues nëpërmjet zyrtarëve të arsimit	P Aktivitet në vijimësi		

	1.3 Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, postera)	P ASH + AM		
B.2 Ngritja profesionale e mësimeve të edukatës qytetare me DHF dhe trajtimin e saj	2.1 Organizimi i trajnimeve të mësimeve të edukatës qytetare për cështje të DHF	P Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2023, 25% e orëve të edukatës qytetare do të kalojnë në tematika të DHF	Institucioni Përgjegjës: Drejtorja e Arsimit
	2.2 Ngritja e qendrave didaktike të integruara me programe të vecanta për trajnimin mbi cështje të DHF	P AM		Institucione Partner: OJQ
	2.3 Organizimi i vizitave studimore për shkëmbimin e përvojave me vendet e rajonit	P AM		

B.3 Ujia e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e ulët dhe të lartë si rezultat i DHF, në zonat rurale apo komunitete të ndryshme	3.1 Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve të familjeve ku ushtrohet dhunë	P+M+R ASH	Deri në vitin 2023, ulet numri i nxënësve që braktisin shkollën prej DHF	Institucioni Përgjegjës: Drejtoria e Arsimit Institucione Partner: Mekanizmi kordinues
3.2 Vetëdijësimi nëpërmjet lidërëve të komuniteteve dhe ndërmjetësuesve përmes takimeve dhe punës me familje të vecanta që shfaqin probleme të DHF	P+M+R ASH+AM			
3.3 Monitorimi i aplikimit të masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës	P+M ASH+AM			

FUSHA E VEPRIMIT – C. FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon në parandalimin, mbrojtjen dhe rintegrimin përmes mbështetjes ekonomike dhe dhënien e mundësive për mirëqënien e të mbijetuarave të DHF dhe të familjeve të tyre si dhe kryerësve të veprës penale

Drejtimi strategjik	Aktivitetet	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit	Indikatori i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
C. 1 Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim	1.1 Rregjistrimi, evidencimi dhe orientimi i viktimave të DHF pranë komunës	M+R AM	Brenda 5 viteve sistemi i regjistrimit dhe orientimit bëhet funksional sipas standardeve kombëtare në përpunim	Institucioni Përgjegjës: Komuna
	1.2 Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës	M+R Aktivitetet në vijimësi		Institucione Partner:
	1.3 Hartimi dhe aprovimi normave rregullative, përmes krijimit të politikave, për lirin nga taksat komunale në rastet e hapjes së një biznesi të ri	M+R ASH		Sipas përcaktimit të standartit kombëtar

2. Mbështetje socio ekonomike të mbijetuarave të DHF	2.1 Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes	M+R Aktivitet në vijimësi	25% e viktimave nga shërbimet në këtë kategori	Institucioni Përgjegjës: komuna Institucione Partner: Donatorët,
	2.2 Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të vecantë prej komunës	M+R AM		
	2.3 Ndarja e subvencioneve për familjet në zonën rurale përmes ndarjes së farërave pranverore dhe vjeshtore	P+M+R AM		
	2.4 Përkrahje e strehimoreve "LIRIA" për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarave të DHF	M+R Aktivitet në vijimësi		
	3.1 Pagesa e qirasë për vendstrehimin e viktimave të dhunës në familje	M+R Aktivitet në vijimësi		
3. Zgjidhje afatmesme e strehimit për rastet e të mbijetuarave të DHF	3.2 Ofrimin e mbështetjes ekonomike përmes pagesës së qerasë për rastet e pazgjedhura	M+R AM		Institucioni Përgjegjës: Komuna Institucione Partner: Donatorë

FUSHA E VEPRIMIT – D. FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NËRINSTITUCIONAL



Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon të ketë institucione funksionale dhe të mirëkordinuara për parandalimin, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe riintegrimin e tyre dhe të familjeve në jetën ekonomike dhe sociale të komunës.

Drejtimi strategjik	Aktivitetet	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit	Indikator i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
D.1 Institucionalizimi i Mekanizmit kordinues në nivel të komunës	1.1 Takime me strukturat udhëheqëse të komunës për qartësimin e roleve dhe përgjegjësi	P+M+R ASH	Të paktën 4 takime të organizuara cdo vit	Institucioni Përgjegjës: MK
	1.2 Takime periodike të Mekanizmit Kordinues për shkëmbim informacioni dhe kordinimin e veprimeve konkrete..	P+M+R Aktivitet në vijimësi		
D.2 Rritja e vetëdijes për identifikimin sa më të hershëm të situatave të rrezikut për DHF prej secilit institucion dhe planifikimin e	2.1 Hartimi i formularëve të posacëm për raportimin e rasteve të rrezikut për DHF dhe rasteve të identifikuara	P+M ASH	Deri në fund të vitit 2023 institucionet e komunës do të kenë të ngritur sistemin e identifikimit, regjistrimit dhe	Institucioni Përgjegjës: MK
				Institucione

masave parandaluese					
2.3 Identifikimi i shkaqeve që paraprijnë rastet e DHF permes analizimit me anë të anketimeve në shkollë, institucione shëndetësore, diskutimeve mediatike me specialistë	P+M AGJ	Vlerësimi të rasteve të DHF.		Partner: OJQ, shkollë	
		Të dhënat për shkaqet dhe situatën janë të mbledhura në bazë periodike			
2.4 Planifikim i punës dhe mbështetjes institucionale për grupet më vulnerabel për DHF (përfshirë pleqtë, të rinjtë dhe njerëzit me nevoja te vecanta)	P+M+R AGJ	Numri i raste të ndihmuara/rehabilitu ara			



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitina

Nga: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Për: Kuvendin Komunal Viti

Lënda: INFORMATË MBI PËRGATITJEN E TË MBJELLAVE VJESHTORE

Komuna e Vitisë është njëra ndër komunat me sipërfaqen më të madhe të mbjellur me kultura të ndryshme bujqësore në Kosovë. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural çdo vit harton planet e mbjelljeve vjeshtore dhe pranverore, ku në bazë të këtyre planeve parasheh sipërfaqet që do të mbjellën me kultura të ndryshme bujqësore. Andaj edhe gjatë këtij viti DBPZHR ka hartuar planin e mbjelljeve vjeshtore ku ka paraparë sipërfaqet që do të mbjellën për çdo kulturë bujqësore.

Përveç planit të mbjelljeve DBPZHR ka vizituar të gjitha pikat shitëse të imputeve bujqësore për të parë se sa janë të furnizuara me impute bujqësore dhe kanë konstatuar se janë të furnizuara mjaftë mirë me impute bujqësore dhe fermerët tanë mund të furnizohen në këto pika me impute bujqësore.

Po ashtu zyrtarët e drejtorisë kanë bërë vizita në teren ku kanë parë nga afër përgatitjen e fermerëve për mbjelljen e kulturave vjeshtore dhe në bazë të verifikimeve në teren mbjelljet kanë filluar në afatin optimal mirëpo janë duke vazhduar të mbillen më vonese për shkak të thatësisë.

DBPZHR ka planifikuar që të mbillen me kultura bujqësore këto sipërfaqe.

Grurë 4850/ ha, Elb 4/ ha, Theken 8/ ha, bimë foragjere 7/ ha. Gjithsej janë planifikuar të mbillen 4889/ ha.

Rendimentet e planifikuar për hektar Grurë- 5000 kg për ha
Rendimenti i planifikuar për elb 3000 kg për ha
Rendimenti i planifikuar për thekër 2500 kg për ha
Rendimenti i planifikuar për bimë foragjere 4000 kg për ha
Rendimenti i planifikuar për tërshërë 2500 kg për ha

Me respekt!

Më:15.11.2019

Drejtore e DBPZHR-së

Arlinda Sahiti

